



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 08

Datë: 22. 01. 2021. Ora: 14:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Valdete Daka, kryetare e KQZ - së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Alim Rama, Eshref Vishi, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Artan Asllani, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.

Përkthyes: Argjina Misini

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

-
- 1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së:**
 - 2. Aktivitetet e SKQZ-së**
 - 3. Raport i Këshillave të KQZ-së:**

Këshilli për Çështje Ligjore

-Shqyrtimi dhe miratimi i Udhëzuesit për Komisionin Komunal të Zgjedhjeve dhe Këshillat e Vendvotimeve për Identifikimin e Votuesve në Vendvotim për zgjedhjet parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2021,

-Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal në Pejë

- 4. Aktivitetet e ZRPPC-së**

-Shqyrtim dhe miratim i rekomandimit për akreditim të vëzhguesve

-Shqyrtim dhe miratim i rekomandimit për certifikim të subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre

5. Të ndryshme.

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së:

Valdete Daka: Përshëndetje të gjithëve. E hapi mbledhjen e 8 të KQZ-s. Me rendin e ditës që e keni para jush. A ka dikush vërejtje në këtë rend dite? Nëse jo. Vazhdojmë me rend dite. Nëse nuk ka vërejtje. Kush është për këtë rend dite?

Miratohet rendi i ditës!

2. Aktivitetet e SKQZ-së

Burim Ahmetaj: Të nderuar anëtarë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Sekretariati është në periudhën e shërbimit votues që janë dy aktivitete. E para që është regjistrimi i votuesve jashtë Kosovës, periudhë e cila është përfunduar 21 janar në ora 18:00 dhe periudhat tjetër është periudha e shërbimit të votuesve për regjistrim të kategorisë së personave me nevoja të veçanta. Si dhe periudha tjetër është ndërimi i qendrave të votimit. Pra këto janë ato aktivitetet të cilat janë kryesore aktualisht duke u zhvilluar në sekretariat. Nga aplikimet për regjistrim, proces i cili është mbyllur me 21 janar, pra deri më tani janë proceduar 33.500 aplikacione për regjistrim. Ku prej tyre vlerësimi i zotësisë juridike është bërë për rreth 22.400 aplikacione. Prej tyre 17.900 aplikacione kanë aprovimin. Ndërsa në statusin momental të refuzimit janë 4500 aplikacione për regjistrim të cilat sigurisht i kemi dërguar edhe e-mile aplikuesve të dërgojnë dokumente shtesë. Në mënyrë që të arrihet qëllimi i aprovimit. Pra jemi në proces të pritjes së dokumenteve për rreth 4500 aplikues. Nga procesi i përmbylljes së procesit të aplikimit të votimit përmes postës apo votimit jashtë vendit. Aktualisht mbrëmë duke ju referuar orës 18:00 pra të datës 21 janar janë rreth 134.188 e-maila të pa hapura të cilat mendojmë ti procedojmë gjatë ditëve në vazhdim. Pra për këtë qëllim kemi ngritur kapacitetet me staf për mbështetje dhe përkrahje të këtij shërbimi. Pra në objektin aktual ku është duke u zhvilluar shërbimi votues për votim jashtë vendit është duke u bërë verifikimi. Pra asaj në QNR kemi shtuar kapacitetet me dy ndërrime me nga 100 staf të cilët do të bëjnë procedimin e të dhënave për regjistrimin e të gjithë votuesve në bazën e të dhënave dhe krahas kësaj. Po ashtu në dy ndërrime në të gjitha aspektet në shërbimin votues jemi duke punuar edhe me printimin dhe hapjen e e-mail. Pra i kemi për këtë qëllim, kemi rrit kapacitetet, jemi me 15 printer duke punuar njëkohësisht që të kemi progres sa i përket printimit. Të gjithë materialeve të votuesve që kanë votuar jashtë vendit dhe procedimit të tyre. Po ashtu krahas kësaj e kemi edhe shërbimin për qendrën e thirrjeve.

Pra, tha në vazhdim z. Ahmetaj, edhe ky proces është duke vazhduar. Pra verifikim dhe konfirmimin e aplikacioneve për regjistrim. Më lejoni t'ju siguroj anëtar të KQZ-s dhe të gjithë votuesit që kanë aplikuar përmes postës se të gjithë aplikimet e tyre do të printohen, do të regjistrohen në bazën e të dhënave, dhe

do ti nënshtrohen procesit të verifikimit. Pas kësaj varësisht kush e fiton zotësinë për të marrë konfirmimin, pastaj do ti thërrasim me qëllim të verifikimit pra nga qendra e thirrjeve secilin aplikues. Është një proces i zgjatur, është dashur të rrisim kapacitetet me qëllim të realizimit të këtij procesi. Jemi duke punuar në dy ndërrime në të gjitha hapësirat ku është dashur ta mbështesim këtë operacion. Pra nga qendra e thirrjeve nga 15.672 aplikues prej tyre 13.072 aplikues kanë hapur telefonin dhe kemi komunikuar me ta dhe kemi marrë konfirmimin e tyre. Prej tyre 14 aplikues kanë deklaruar që nuk janë persona të cilat i kemi të dhënat, pra për të cilët është aplikuar. Ndërsa 2.460 aplikues nuk janë realizuar thirrjet telefonike. Pra këtij procesi do ti kthehemi sërish për ti thirrur të gjithë këta aplikues të cilët janë në pritje apo nuk kemi mundur të kemi kontakt për momentin. Por sigurisht që do të punojmë me kapacitete të njëjta në dy ndërrime me qëllim të regjistrimit të gjithë votuesve në bazë të dhënave, verifikimet e tyre, dhe thirrjen përmes telefonit. Pra është një proces që nuk mund të themi që mund të realizohet brenda pak ditësh. Sepse siç e thashë ma herët i kemi duke ju referuar orës së mbrëmshme janë dikur rreth 134.000 e-maile të pa hapura. Duke ju referuar thirrjeve nga qendra e thirrjeve në përqindje, me statistikat edhe të dhënat të cilat i kemi 88.40% të thirrjeve të cilat janë realizuar dhe kemi konfirmim. Pra pjesa tjetër e mbetur sigurisht që do ti nënshtrohen prapë thirrjeve dhe do të tentojmë thirrjeve dhe komunikimin me ta. Sa i parkete periudhës së shërbimit të votuesve dhe ndërrimit të qendrave të votimit kemi 2.000 votues të cilët kanë aplikuar për të ndërruar qendrën e votimit përmes aplikacionit dhe platformës online. Dhe 650 votues kanë aplikuar nëpër komuna për ndërrimin e qendrave të votimit. Ndërsa të kategoria tjetër sigurisht që e njëjta periudhë nga shërbimi votues pra nga divizioni i shërbimit votues. Numri i votuesve të regjistruar si votues me nevoja të veçanta deri më tani është 1.495 të cilët në ditën e zgjedhjeve do të mund të votojmë përmes ekipeve mobile. Pra ky operacione ka filluar me 14 dhe është përmbyllur me 18 janar. Pra në mbështetje të gjitha këtyre operacioneve, sekretariati ka rritur kapacitetet dhe është duke punuar në katër objekte të ndryshme për shkak të hapësirës, për shkak edhe të respektimit të masave anit covid, por sidoqoftë jemi duke punuar me dy ndërrime me staf dhe kapacitete të shtuara me qëllim të procedimit e të gjitha aplikacioneve të cilët qytetarët i dërgojnë për të aplikuar dhe për tu regjistruar si votues jashtë vendit. Pra këtu në pika të shkurta janë të gjitha aktivitetet pothuajse të sekretariati, pjesa tjetër teknike është në proces e sipër dhe nëse keni pyetje mund të përgjigjemi.

Valdete Daka: A ka dikush pyetje?

Alim Rama: Faleminderit në raport Burim. Si e pash unë, diku 0.1% e atyre që kanë thënë nuk kanë aplikuar prej 14.000. Por mua më shqetëson fakti duke e pasur parasysh që numri i e-maileve të pa hapura nuk

është zvogëluar prej disa ditësh, gjithmonë kemi rritje. A je i sigurt që me këto kapacitete dhe me këto ndërrime ky plan mundet të realizohet sipas planit operacional.

Burim Ahmetaj: Faleminderit kryetare. Faleminderit për pyetjen Z. Rama. Sigurisht që do të reflektojmë edhe karshi operacioneve që do të mund ti realizojmë. Aktualisht i kemi 15 njësi të cilat hapin e-maile dhe i printojnë secilin aplikacion që vjen. Mirëpo do ta kemi një vlerësim sot dhe nesër, nëse ka nevojë ,patjetër do të duhet ndoshta ti shtojmë prapë kapacitet në aspektin e hapjes së e-maileve dhe shkarkimit të gjithë atyre aplikacioneve në mënyrë që ti procedojmë në bazën e të dhënave. Dhe nëse ngritët nevoja ndoshta do të na duhet me aktivizua edhe ndërrimin e tretë, natën me 100 vet. Aktualisht i kemi 100 staf të cilët procedojnë të dhëna me ndërrimin e parë në QNR. Të gjithët janë staf ditor dhe kanë përvojë në procedimin e të dhënave. Po ashtu njëjtë është në ndërrimin e dytë ku i kemi edhe 100 staf dhe pasi ta bëjmë një vlerësim gjatë ditës së sotme dhe të nesërme. Nëse paraqitet nevoja sigurisht që do të na duhet të shkojmë me ndërrimin e tretë në mënyrë që ti procedojmë të gjitha këto. Mirëpo me numrin e madh të e-maileve të cilat nuk janë proceduar kamë frikën se nuk do të mund ta mbërrijmë periudhën e sfidimit e cila është paraparë me planin operacional. Kështu që rrezikohet tej mase me këtë aspekt, periudha e sfidimit dhe e kundërshtimit. Kështu që, do të na duhet të reflektojmë varësisht edhe prej procedimit të materialeve...

Čemailj Kurtiši: Unë ju kisha pyetur çka keni ndërmarrë, dhe ndoshta ju keni ndërmarrë sepse është dashur të ndërmerrni, që të gjithë ata që lajmërohen të konfirmohen ngase, disa janë ankuar se janë lajmëruar në gjuhën boshnjake nuk kanë marrë përgjigje, në mënyrë që të gjithë të votojnë...Janë disa raste, dhe të angazhoheni që atyre, tu sigurohet komunikimi edhe në gjuhën boshnjake..

Valdete Daka: Po Burim.

Burim Ahmetaj: Faleminderit kryetare. Faleminderit Z. Kurtishi. Sigurisht që kemi marr për bazë dhe kemi marr parasysh edhe votuesit të cilët nuk mund të komunikojnë në gjuhën shqipe. Po ashtu kemi marr parasysh edhe të fokusohemi në votues të cilët mund të flasin edhe gjuhën turke, kështu që në kuadër të qendrës së thirrjeve prej kërkesës. Kemi vepruar që të kemi një staf i cili do të komunikojë në gjuhën serbe dhe në gjuhën boshnjake. Dhe një staf që mund të komunikojë në gjuhën turke. Këto janë gjuhët zyrtare sigurisht që i kemi marr për bazë dhe i kemi marr parasysh këto aspekte dhe kemi, sigurisht që do ti kemi të angazhuar me stafin në qendrën e thirrjeve.

Valdete Daka: Po urdhëro Sami.

Sami Kurteshi: Faleminderit. Kemi pa edhe në media por edhe unë kam marr mesazhe se dje shumë njerëz që sigurisht momentin e fundit, kanë dashtë me aplikuar, por para orës 18:00 natyrisht. Kanë aplikuar edhe marrin përgjigje nga serverët e KQZ-së se është mbyllë faza e aplikimit para orës 18:00. Tash a ka pas ndonjë problem apo vërtet është mbyllë apo i kanë marr ata gabimisht ato e-maile. Natyrisht tash këto e-maile tash kjo teknika tregon kohën e saktë me minuta, me sekonda, kur është dërguar, kur e ka marr përgjigjen. Nëse qëndron kjo që po e them unë a do të bëni përpjekje me i përfshi edhe ato aplikacione brenda, njerëzit mos me u detyruar me u ankuar për çështjet. Një të drejtë që është caktuar deri në ora 18:00.

Burim Ahmetaj: Faleminderit kryetare. Faleminderit Z. Kurteshi për pyetjet. Janë diku 4.500 aplikues të cilët ju kemi dërguar e-maile, për të na dhanë, apo për ti dërguar dokumentet plotësuese me qëllim të plotësimit të dokumentacionit dhe pastaj ti nënshtrohen verifikimit. Pra kjo është në statusin e pritjes mirëpo nuk e kanë statusin e refuzimit. Nëse nuk kemi pas përgjigje deri në kohën e caktuar, sigurisht që tani do të kalojnë në statusin e tyre. Kjo i referohet raportimit të djeshëm, sigurisht që do të kemi progres, mirëpo në raportimin tjetër do ti kemi të dhënat e sakta sa i përket kësaj. Ndërsa sa i përket e-mailit, në orën 18:00 e kemi aktivizuar auto përgjigjen që ju kthehet të gjithë votuesve të cilët aplikojnë pas orës 18:00 dhe sigurisht që ju ka shkuar për shkak të trafikut shumë të madh. Kam konfirmimin që ju ka shkuar me vonës ai mesazh, që është auto përgjigje dhe sigurisht që më konfirmohet prej sekretariatit se në orën 18:00 është bërë aktivizimi i auto përgjigjes. Kështu që ndoshta mund të jetë problem teknik ose në qoftë do ta shohim çfarë problemi nëse mund të jetë problem. Mirëpo e kam konfirmimin nga sekretariati se në orë 18:00 është aktivizu auto përgjigja që ju thotë se ka përfunduar periudha e aplikimit për regjistrim jashtë vendit. Faleminderit.

Ibrahim Selmanaj: E kisha falënderua kryeshefin, për njoftimin dhe raportimin që e bëri dhe të njëjtën kohë sugjeroj kryeshefin por edhe administratën që të jenë të përkushtuar dhe nëse duhet të shtohet stafi gjithsesi merren masa urgjente se kemi të bëjmë me një numër të madh të e-maileve të cilat kanë ardhur dhe se është e domosdoshme të mbërrihet afati ligjor edhe tu kthehet përgjigje të gjithë njerëzve, të gjithë qytetarëve tanë që kanë aplikuar për zgjedhje. Të jemi shumë efikas në këtë drejtim, sepse koha po ecën edhe duhet ti kthemi përgjigje. Vetëm ky ishte sugjerimi im.

Valdete Daka: Faleminderit. Nëse nuk kemi më pyetje. Vazhdojmë me raportin e këshillave të KQZ-së. Këshilli për çështje ligjore.

3.Raport i Këshillave të KQZ-së

Këshilli për Çështje Ligjore

1.Shqyrtimi dhe miratimi i Udhëzuesit për Komisionin Komunal të Zgjedhjeve dhe Këshillat e Vendvotimeve për Identifikimin e Votuesve në Vendvotim për zgjedhjet parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2021:

Arjanit Elshani: Faleminderit shumë kryetare. Këshilli për çështje ligjore ka trajtuar udhëzuesin për komisionet komunale të zgjedhjeve, dhe këshillat e vendvotimeve për identifikimin e votuesve në vendvotim për zgjedhjet parakohshme për kuvendin e Kosovës 2021. Ky udhëzues realisht ka qenë edhe në zgjedhjet e vitit 2019-të edhe në zgjedhjet e fundit të Podujevës dhe Mitrovicës së Veriut. Andaj meqenëse është vendos edhe një praktikë e mirë dhe i lehtëson edhe punën pastaj të komisionarëve në vendvotime. Kemi rekomanduar serish që të aprovohet ky dokument para së të hymë në procesin e zgjedhjeve. Faleminderit. Andaj i rekomandojmë KQZ-së për miratim.

Valdete Daka: A ka dikush pyetje? Nëse jo. Atëherë kush është për aprovimin u udhëzuesit të KKZ-ve dhe KVV-ve për identifikimin e votuesve në vendvotim për zgjedhjet e parakohshme për kuvendin e Kosovës 2021. Miratohet...

2.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal në Pejë

Arjanit Elshani: Faleminderit kryetare. Këshilli për çështje ligjore ka shqyrtuar kërkesën për zëvendësimin e anëtarit të kuvendit komunal në Pejë. Dhe meqenëse ka kaluar të gjitha filtrat ligjore dhe nga zyrtari i lartë komunal i Pejës dhe ka pasur të bashkangjitura të gjitha shkresat e nevojshme. Kemi trajtuar këtë çështje dhe si këshill për çështje ligjore rekomandojmë për miratim edhe sot këtu në KQZ-së. Për sqarim për Z. Kurteshi, ka qenë edhe vet pjesë e mbledhjes, nuk ka të beje në lidhje me çështje gjinore në mbikalim të personave. Faleminderit.

Valdete Daka: Kush është që Z. Blerim Nikqi të emërohet anëtar i kuvendit komunal në Pejë. Nga subjekti politik AAK duke zëvendësuar anëtarin e kuvendit komunal Z. Sadri Murtezaj. Kush është për? Miratohet rekomandimi...

4.Aktivitetet e ZRPPC-së

1.Shqyrtim dhe miratim i rekomandimit për akreditim te vëzhguesve:

Yll Buleshkaj: Zyra është duke kryer aktivitete e rregullta, një nga to është akreditimi i vëzhguesve që janë të interesuar të vëzhgojnë zgjedhjet në Kosovë. Kemi pranuar 4 aplikacione nga OJQ dhe kemi pranuar 3 aplikacione nga mediat. E kemi aplikacione nga VIMDO nga 6 vëzhgues, nga OMCD 1 vëzhgues është një organizatë ndërkombëtare. Nga organizata D4D me 10 vëzhgues, organizata e GERMIN me 6 vëzhgues. Me media radio kemi pra 3 vëzhgues, radio MOST dhe TV MOST kemi 11 vëzhgues dhe radio KM 6 vëzhgues. E kanë plotësuar dokumentacionin sipas kërkesës i cili përbën përshkrimin e deklaratës si dhe të dhënat e tyre personale e rekomandojmë për aprovim ashtu siç e sheh edhe ligji. Para jush e keni raportin pak ma të detajuar. Në qofte se keni ndonjë pyetje. Numri i përgjithshëm është 41.

Valdete Daka: Atëherë kush është për aprovimin e rekomandimit nga zyra pra për akreditimin e vëzhguesve. Nëse doni i lexojmë kush janë. Faleminderit. Kush është për? Miratohet ky rekomandim. Faleminderit. Vazhdojmë me pikën tjetër: Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për certifikimin e subjekteve politike dhe kandidateve të tyre. Na e kemi marr pra sot një rekomandim nga zyra për certifikimin e subjekteve politike dhe kandidateve të tyre. Nëse ka nevojë drejtori me na dhanë shpjegime...

2.Shqyrtim dhe miratim i rekomandimit për certifikim të subjekteve politike dhe kandidateve të tyre

Yll Belushkaj: Ka qenë një proces mjaftë i gjatë i shoqëruar me punë të gjatë deri 16 orë në dite tu i shqyrtuar aplikacionet e partive politike në detaje. Ashtu si e dini edhe ju fillimisht i kemi pas 1081 kandidatë nga 25 subjekte politike. Finalja është 1075 nga të njëjtat subjekte politike. Të gjitha subjektet politike i kanë plotësuar kriteret minimale dhe ne ashtu siç e keni në vendim i kemi rekomanduar certifikimin e tyre. Për ato që aplikohet ndërsa për ato që aplikohet vetëm certifikimi i kandidateve e tyre ashtu siç kanë aplikuar. Për shpjegim kemi kërkuar shkresa nga institucionet e ndryshme për të na ndihmuar në vendimmarrje dhe disa na kanë ndihmuar e disa na kanë konfuzuar. Ajo çka vlen të theksohet

është që zyra nuk ka arrit me zbatuar plotësisht, me vendim në bazë të pikës apo shkronjës Q në nenit 29 për arsye të interpretimit të ndryshme e për at arsye zyra ju rekomandon juve që ta certifikoni listën ashtu siç është, ndërsa palët e interesuara në qoftë se kanë ndonjë ankesa munden pastaj ta bëjnë ankesën në institucionet e tjera për largimin e kandidatëve. Kjo nuk asht hera e parë që një institucion tjetër të largoj kandidatë, ka pas edhe ma përpara. Nuk janë sipas pikës Q kemi edhe ankesa tjera kur në listë të një komuniteti ka kandidatë të ndonjë komuniteti tjetër. Ne kemi raste të komuniteti boshnjak ku mendohet që është një kandidatë nga komuniteti shqiptar, apo të komuniteti egjiptian ku ka kandidatë nga komuniteti rome, apo ku ka në qoftes se te pika Q , ku nuk jemi të sigurt edhe kur fillon afati 3 muor apo jo. Për shkak të korrektësisë i kemi njoftuar secilin subjekt politik me të dhënat që i kemi pranuar nga secili si institucion. Ju kemi ofruar mundësi që vullnetarisht ti zëvendësojnë kandidatet, disa i kanë bërë disa jo. Kështu që na i qesim ashtu siç kanë rekomanduar edhe subjektet politike ashtu siç kanë aplikuar, e rekomandojmë verifikimin e këtyre kandidatëve të subjekteve politike, ndërsa pastaj rrjedhin afatet për ankesën , nëse dikush është i interesuar .

Valdete Daka: Vetëm kisha dashtë me qenë e sigurt për atë çka dëgjova. A i plotësojnë të gjitha kushtet ligjore nga neni 29 të gjitha subjektet politike. A i plotësojnë të gjitha subjektet politike, kërkesat ligjore nga neni 29-të.

Yll Beleshkaj: Të gjitha subjektet politike si subjekte politike, i plotësojë të gjitha kriteret. Ka kandidatë që mund të kenë probleme. Zyra nuk ka mund me a verifikuar a kanë me të vërtet probleme me pikën Q për arsye të hamendësi të zyrës por edhe informatat që ka marr të dy anshme nga institucionet e ndryshme. Ne e dimë edhe shembullin ku një ministri na ka dërguar mbrëmje një shkresë me disa diplomat, mëngjes ka thanë nuk janë diplomat. Këto na kanë dhënë dyshim për te rekomandimi duke u nisur gjithmonë tek gjithë përfshirja duke i përfshirë sa ma shumë në mënyrë që filtrat tjerë ti pastrojnë. Rekomandojmë që të përfshihen të gjithë nga KQZ-ja ndërsa filtrat tjerë mund ti largojnë në qoftë se kanë fakte. Kjo është qasja jonë . Qasja e gjithë përfshirjes sepse besoj që nuk kemi kapacitete që ta vlerësojmë saktë në qoftëse një kandidatë është ashtu siç na ka dërguar KGJK-ja në qoftëse është i dënuar. Kemi probleme e dini edhe me afatin kohor deri kur fillon afati dhe besojë që neve shumë na kish kryer punë vlerësimet , institucionet e tjera gjyqësore të cilët na kishin sqaruar qartë se si janë këto elemente që në zgjedhje e ardhshme ti zbatojmë ashtu siç thotë ligji. Pra kjo është ajo. Si zyre kurdo që hamendësohemi për një çështje, sidomos kur ka të bëjë me mjete drejt bazike të kandidimit atëherë, më shumë jemi për gjithë përfshirje ku e dimë

që I kemi filtrat tjerë që mund të kontrollojnë një gabim që është I mundshëm. Kjo është gjithë përfshirja para largimit. Faleminderit.

Valdete Daka: Faleminderit Yll. Po me duket na the që kemi marr përgjigje nga institucionet në të cilat ke dërguar shkresa për verifikimin e kandidatëve sepse kjo ka qenë ajo tema e cila ju ka djeg të gjithëve ?! Pra, verifikimi i kandidatëve është bërë nga 6 institucione dhe ne këto sot nga ky rekomandim nuk e kemi të qartë se cilët kandidatë I plotësojnë kushtet e të cilët jo. Kërkesa dhe zyra është ajo e cila e bënë filtrimin dhe e cila I dërgon rekomandimin duke u bazuar në kërkesën ligjore nga neni 29-të. Kërkesat janë dërguar në të gjitha institucionet relevante dha pas marrjes së përgjigjeve nga këto institucione është kërkuar nga subjektet politike që të ndërrohen apo të zëvendësohen kandidatët të cilët nuk I kanë plotësuar këto kritere. Unë këtu para vetit e kamë një rekomandim I cili në fakt nuk na shpjegon se a I përmbushin këta kandidatë kriteret apo jo. Faktikisht na nuk e kemi të qartë nga ky rekomandim se kush I përmbushë kërkesat, kush nuk I përmbush kërkesat. Kjo është detyra e parë e zyrës, pra zyra është ajo e cila I pranon dokumentet, i verifikon, i klasifikon dhe në fund mbi bazën e atyre dokumenteve të cilat I pranon edhe e bënë një rekomandim gjithnjë duke u respektuar dispozitat e nenit 29-të. Unë kisha dashtë që neve së pari të na sillen të gjitha dokumentet sepse na këtu nuk kemi dokumente. Na e kemi një rekomandim I cili nuk na thotë asgjë. Rekomandimi na thotë që të certifikohen të gjithë kandidatët edhe ata kandidatë, edhe ato subjektet të cilat I kanë zëvendësuar kandidatë.

Tash, shtroi mendimin e saj z. Daka se, është e pa qartë se tash a do të mbesin kandidatë të cilët janë zëvendësuar, sipas kërkesës së zyrës. Apo do të mbesin ata kandidatë të cilët partitë I kanë dërguar sepse tashmë kjo nuk është e qartë me këtë rekomandim. Pra subjektet politike të cilët I kanë zëvendësuar kandidatët e tyre me të drejtë, munden me ngrit çështjen dhe me thanë që na tash I kemi zëvendësuar kandidatët tonë dhe kërkojmë që të kthehen kandidatët të cilët kanë qenë fillimisht. Sepse kjo ka ndodhë prandaj ndoshta kishte me qenë shumë ma në rregull që të na sillen të gjitha shkresat. Komunikimi që është bërë në mes të zyrës dhe institucioneve të tjera dhe pastaj të dihet se çka ka ndodhë. Sepse na tash praktikisht nuk e kemi të qartë çka është duke ndodhë dhe çka po ndodhë. Po urdhëro.

Yll Beleshkaj: Ashtu siç e shihni në rekomandim shumë qartë është që për zyrën të gjithë I kanë plotësuar kushtet. Vështirësia ka qenë të Q të cilën nuk kemi mund ta zbatojmë plotësisht sepse nuk kemi pas qartësi. Rekomandimi është shumë I qartë, rekomandimi është që të gjithë. Ju e dini kryetare të paktën e kërkuar të gjithë .. por edhe me partitë politike. ZRPP-ja në komunikim me parit politike apo subjektet

tjera , asnjëherë nuk ka kërkuar zëvendësimin. I kanë kërkuar. Është shumë e qartë në shkresën që është dërguar, në qoftese janë të interesuar ti zëvendësojnë, ti zëvendësojnë. Kjo ka qenë një njoftim nuk ka qenë kërkesë. Kështu që partitë politike të cilat kanë dashtë vullnetarisht që kanë konsideruar që ndoshta këta kandidatë mundë të zëvendësohen me më te mirë atëherë janë zëvendësuar. Vullnetarisht gjithmonë. Nuk ka pas kërkesë asnjëherë nga zyra që I ka obliguar asnjë subjekt politik. I kemi këtu. Po ti kishin obliguar kemi 3 subjekte të mëdha të cilat me shkresa na kanë kthyer , kanë thanë që nuk dëshirojnë mi ndërruar, vazhdoni me këta sepse nuk kemi interes. Kemi pas ankesë nga një subjekti politike me shkrim i shumicës, 2 ankesa nga komunitete të pakicës sepse e kanë keqkuptuar fillimisht, kanë menduar që është kërkesë, por kur e kanë lexuar në fund e kanë pa që nuk është kërkesë po njoftim. Të gjitha këto gjana janë, në mundemi me i nda të gjitha sepse nuk ka asgjë sekrete. Përveç të dhënave personale të kandidatëve të cilat edhe ashtu janë shpërnda në mënyrë pakë më të autorizuar. Por sido që të jetë na mundemi me i nda, në qoftese mendon KQZ-ja që mund të grumbulloj interpretim profesional se sa zyra edhe mund ta bëjë. Ky është rekomandimi që e jep zyra që nuk ka probleme profesionale me të. Profesionalisht mendojmë që më së miri është kjo. Pastaj ju të gjithë mund ti shqyrtoni.

Unë, tha z. Buleshkaj, jam i shumë i gatshëm ti jap të gjithë korrespondencën që kemi pas edhe me institucionet e jashtme, përveç të dhënave personale. Të dhënat personale në asnjë mënyrë nuk guxojmë me i nda. Edhe tash nuk guxojmë me i nda sepse ligji, neni 30-të na thotë që nuk guxon me i nda pa u certifikuar. Nuk guxojmë t`ju tregojmë me emra as juve, se kush ka qenë i dënuar. Sepse ligji thotë pas certifikimit e ka atë autorizim zyra. Na mundemi mi jep gjithçka për veç të dhënave personale.

Sami Hamiti: Vendimet kanë ardhur me një kërkesë. Neni 29, pika Q. Edhe ty nuk të jep të drejtë me interpretuar çfarë janë. Ti e zbaton pikën Q. Qatë kërkesë apo thajë qysh të duash njoftim. Ja u ke dërguar subjekteve politike për zëvendësim. Tash e kemi diktuar këtë punë nuk është që nuk e kemi diskutuar në KQZ. Edhe në mesin tonë ata zëvendësohen kush s`dëshiron mbesin në vendet të cilat deri sa merret një vendim në gjykatë. Por diçka ka ndryshuar ndërkohë, ti duhesh me tregu. Çka ka ndikuar ti me i ndërruar qëndrimet, sepse e dinë shumë saktë dhe shumë mirë që kjo çështje më tepër u banalizua më tepër, se një interpretim që vjen edhe e ke për detyrë saktë me e interpretuar. Në kuptimin, neni 29 në pjesën që kanë ardhur ato shënime edhe disa subjekteve që kanë zëvendësuar dhe I kanë dhënë mundësinë me i zëvendësuar deri në këtë kohë. E keni mundësin me i zëvendësuar disa subjekte se është neni 29 në bazë të aktgjykimit janë ardhur dhe I kanë zëvendësuar. Por me thanë ti që I kanë përmbush kriteret, me thanë ti që nuk I kit të qarta edhe saktësisht, nuk po e dinë çka të ka ardhur. Nga këshilli gjyqësor me drejte se

ki, dhe ke hy në atë. Prandaj njësoj si kryetarja kërkojë të gjithë komunikimet qysh kanë shkuar, letrën qysh ja ke dërguar. Qysh të ka ardhur letra, se ti kërkesën sa e di unë këshilli gjyqësor I ka thanë për pikën këtë, këtë edhe këtë. Kush janë kandidatët që nuk e plotësojnë. Ti ke dalë jashtë asaj dhe jashtë ligjit dhe tashmë po i plotësojmë, prandaj gjithë atë komunikim na e sjell, ne e shohim edhe takohemi pas një kohe dhe e analizojmë dhe marrim vendim.

Yll Beleshaj: Prej që kam ardhur ne zyre, kam synuar me I pas vendimmarrja me kanë zyrtare. Jo me takime. Kemi pas edhe takime por vendimmarrja të jetë zyrtare. Zyra e ka një kompetence të caktuar të cilën e ushtron. Për sa kohë zyra asnjëherë nuk dalin drafte të dokumenteve të ndryshme, ndërkohë. E dimë ka dalë edhe në media drafte të tjera të cilat janë kanë të pa autorizuar plotësisht, edhe këtu ka mundësi që ka pas drafte të ndryshme të punës sepse ne jemi përgatitur si zyre edhe e dimë që kur na vjen momenti edhe ju mire e dini. Përgjigjja e fundit nga KGJK-ja na ka mbërrin në orën 12:00 sot. Na në 12:00 e kemi integruar. Kemi bërë me dhjetëra drafte... Nuk mundem me marr vendim, rekomandim me I largu, unë ju kam jep mundësi subjektit politik vet ata të vendosin. Disa kanë vendos, disa nuk kanë vendos. Për arsye na e dimë ka raste aty përzihet në vendimet sepse nuk janë të klasifikuara. Ka raste nga dënimi, shumë banal deri tek aktet shumë të rënda. Zyra nuk I hup të drejtën askujt që të ankohet dhe të largohet në qoftes ka dëshmi. Por unë nuk mendoj se duhet të largohen të zamë 12 kandidatë, apo 4 apo 5 dikujt, pa qenë i sigurt juridikisht. Por më shumë e dini të gjithë, kam pas një telefonat ku edhe nga institucionet që ka jep të dhënat, ka thanë nuk kemi qenë të sigurte edhe të sakta. Secili që vjen, duhet me vij me i verifikuar. Nuk besojë që ka ndonjë edhe ta zëmë, person i cili merr gjykime në asnjë rast ku ka dyshimin ose më të vogël. Nëse ka dyshime të mëdha atëherë që normal që duhet me u rekomanduar ndryshe në mënyrë që të përfshihen, ndërsa institucionet tjera le ti largojnë. Për atë arsye po të ishte vetëm zyra, filtër atëherë nuk kish ekzistuar as PZAP as gjykata supreme. Në e kemi pas vitin e kaluar i dhuruam të parë, nuk u bë fare verifikimi edhe pse u bë shkresa. Njëjtë keni qenë shumica prej juve këtu, pa vendos se jo nuk po shkojmë. E tash është krejt tjetra. Aktgjykimi merret në një rast të caktuar.

Sami Hamiti: E ki aktgjykimin në gjykatën supreme e cila ka qenë në fuqi. Aktgjykimi i gjykatës kushtetuese ka larguar ata. Jemi në një situatë të re, të cilën ka thanë se duhesh me e marr parasysh nenin 29. Aktgjykimin i gjykatës kushtetuese.

Yll Belushkaj: Jap përgjegjës të plotë profesionale për këtë punë. Për këtë pjesë jepi përgjegjësi, qysh duhet me jep përgjegjësi gjithkush për punën e vet po besoj. Faleminderit shumë.

Alim Rama: Unë nuk e di që, KQZ-ja ka marr rolin e një trupës të specializuar e cila i shqyrton dokumentet. Unë mendoj që për atë punë e kemi zyrën e cila e ka kryer punën e vet. Edhe nuk ka ndodh rasti deri tash që KQZ-ja me e marrë përsipër shqyrtimin ose shikimin e gjitha detajeve për të gjithë aplikuesit. Edhe mos të harrojmë që në asnjë zgjedhje deri tash prej që i bënë institucioni i pavarur, prej 2009 ose 2007-tës sido që të jetë. As të 13-tës as në zgjedhjet e 2017-tës, as zgjedhjet e 2019-tës KQZ-ja nuk ka mundur me implementuar nenin 29 pikën Q. Për shkak paqartësisë ligjore. Edhe na ende gëzojmë paqartësi ligjore. Gjatë diskutimit ne organet e brendshme të KQZ-së kam parashtruar kërkesën që kjo të rregullohet me një rregullore, të qartësohet. Sepse atëherë kemi pas vendimin e gjykatës supreme. Na ende, na jemi të obliguar me e zbatuar aktvendimin e gjykatës supreme. Në ende nuk kemi bërë rregullore për atë punë. Nuk kemi bërë rregullore çka përfshihet se çka nuk përfshihet se KQZ-ja nuk mundet paushall me i largu të gjithë kandidatët ose një. Kështu që unë mendoj nuk ka nevojë dokumentet, ne e kemi një rekomandim edhe na duhet ta votojmë për këtë rekomandim. Qysh na e obligon procedura edhe rregullorja e KQZ-së.

Sami Kurteshi: Unë dëgjova dhe rekomandimin dhe diskutimet. Unë mendoj se, kjo është tema që ka ngjallur interesim të jashtëzakonshëm në Kosovë, nuk është krejt e pa qëllimshme është politike edhe ne me përfaqësuesit e partive politike. Dy çështje që po dua ti theksoj është se ZRPP-ja ka sjell një rekomandim dhe udhëheqësi i zyrës merr përgjegjësin ligjore për veprimet e veta, për rekomandimet e veta. Ne kemi pasur edhe rekomandime të tjera prej zyrës ligjore që kanë kaluar si kanë kaluar por PZAP-i ka pyet. Rekomandimi i zyrës mua më duket i drejt edhe më duket me vend, edhe rekomandimi i zyrës për ndjekjen e hapave të rregullt ligjor për shterjen e mjeteve juridike është në vend. Unë mendoj se qështja është se ne në këtë moment i kemi disa ngushtica për shkak të zgjedhjeve të jashtëzakonshme kemi shkurtuar afate të ndryshme për të gjitha kategoritë thuajse. Ne këtë e kemi bërë në bazë të planit operacional që e ka bërë edhe këshilli dhe mandej është miratuar në këtë KQZ. Unë mendoj se rrugët për shterjen e mjeteve ligjore janë të hapura. Përsëri po e theksoj drejtori i zyrës por edhe secili nga ne si përfaqësues së partive politike por edhe si anëtar të KQZ-s kemi për obligim ti ndjekim të gjitha hapat ligjor, mjetet ligjore që i kemi në dispozicion për ti shqyrtuar çështjet për të cilat mendojmë se janë të kundërligjshme. Në bazë të rregullores, ligjit zyra është organi kompetent që e bënë këtë rekomandim dhe unë jam për jo vetëm për komunikimin dhe këtë rast por unë jam që çdo komunikim, çdo dokument brenda KQZ-s që është dokument publik të jetë i hapur tek i gjithë opinioni, mediat dhe gjitha organizatat e interesuara të kenë qasje të pakufizuar në të gjitha dokumentet që i përmban KQZ-ja. Një e dimë që dokumentet që kanë të dhëna që janë të mbrojtura me ligjin për të dhëna personale gjitha dokumentet e

tjera janë publike janë të një institucioni publik dhe publiku mund të ketë qasje në çdo kohë dhe unë inkurajoj mediat, organizatat, publikun që të kërkoj qasje në të gjitha ato dokumente përfshirë edhe ZRPP-n.

Unë, tha pastaj z. Kurteshi, mendoj se tërheqja zvarrë e certifikimit të listave të kandidatëve të subjekteve politike që e kanë kaluar pragun sipas zyrës kishte për të shkaktuar vetëm pasoja që në të vërtetë e problematizojnë dhe e zvarrit procesin zgjedhor që edhe ashtu është në terme të kufizuara për shkak se këto janë zgjedhje të parakohshme. Prandaj unë po ju bëj ftesë KQZ-s që ta marr për bazë rekomandimin e ZRPP-s, ta kryej këtë veprim ta votoj dhe të hap rrugën për shfrytëzimin e mjeteve juridike të gjithë personave të gjitha subjekteve dhe të gjithë njerëzve që kanë interes juridik dhe duan ta nxjerrin çdo gjë në sipërfaqe. Faleminderit.

Arianit Elshani: E pash me vëmendje rekomandimin edhe pse ishte kohë e shkurtër për ta trajtuar një orë përpara e kemi pasur në e-maillet tona secili, kështu që po besoj që edhe trajtimi i saj dëshiron kohë për rekomandim. Bash mendoj me juve që ti kemi edhe dokumentet dhe shtesat tjera përcjellëse sepse edhe nën 30 që e potencuat realisht atë e ndalon nga publikimi tek publiku në momentin e certifikimit, por nuk e ndalon sekretariatit dhe në këtë rast anëtarët e KQZ-s që ti bie ato e ti procedojmë. Kështu që preferoj që ti kem para vetës ato shkresa me të gjitha agjencionet me të gjitha agjencitë dhe pastaj mund të vazhdojmë me këtë pikë të rendit të ditës kështu që preferoj që të bëhen gati këto. Faleminderit.

Irbahim Selmanaj: Jemi në një situatë që është afuar edhe afati kohor por edhe ligjor për certifikim të kandidatëve për deputet. Në të njëjtën kohë përfaqësojmë subjektet politike, me të cilat subjekte janë të apostrofuara emra, që tashmë janë edhe publik, të cilësuar nga këshilli gjyqësor i Kosovës të cilët nuk i plotësojnë kushtet ose kriteret në bazë të nenit të caktuar dhe kemi një rekomandim të zyrës ligjore tashmë në momentet e fundit. Edhe unë mendoj se duhet pak duhet të shtjellohemi më hollë në shkresat të cilat janë sepse mos te harrojmë po e kthej se jemi përgjegjës para njerëzve tanë, të jemi përgjegjës para njerëzve me autoritet të cilët zgjedhin dhe zgjedhën dhe në këtë moment shkresa, shkresa, rekomandimi ka ardhur shumë vonë dhe mënojmë se duhet të na jepet pak kohë në mënyrë që ta marrim një vendim që të jetë vendim që i përgjigjet edhe kohës dhe nuk bëjmë shkelje. Sepse ne flasim për ligjet, ligjet na rekomandojnë dhe duhet ti përmbahemi rregullave, normave të cilave dhe janë të shkruara pra po mendoj se duhet ta shtyjmë edhe për pak kohë. Ta analizojmë ti shohim shkresat ti shohim dokumentet dhe ta kemi për më vonë.

Eshref Vishi: Është më se e vërtet se ZRPP-ja bënë shqyrtimin dhe aplikimin për përzgjedhjen e subjekteve politike dhe plotësimin dhe verifikimin e kushteve në plotësim të ligjit. Pika më e ndjeshme që ka qenë këto dit dhe plotësimi i kushteve në verifikim e kandidatëve sa i përket nenit 29 paragrafit pika Ç. Thoni se keni pasur komunikim me këshillin gjyqësor të Kosovës dhe në institucione të tjera relevante por megjithatë ju thatë se keni pasur telefonata për këtë çështje dhe keni komunikuar me shkrim. Lidhur me hamendjen që e përmendët ju, kjo hamendje është evidentuar në shkresë apo ju ka thënë juve përmes komunikimit telefonik e nëse është kështu duhet ta shqyrtojmë këtë çështje për arsye se për subjektet politike garuese të cilëve ju hiqen kandidatët nga lista kjo është mjaft e ndjeshme dhe ne duhet ta shqyrtojmë.

Yll Buleshkaj: Shumë faleminderit për pyetjen. Pikërisht pse është e ndjeshme heqja nga lista, zyra ka rekomanduar mos ti heq nga lista kandidatët nga subjektet politike. Duke besuar shumë se kemi institucione të përgjegjshme të gjyqësorit dhe PZAP-it dhe do të kishin korrigjuar këtë lëshim të mundshëm. Pra kjo është pse komunikimi me shkrim dhe kemi pasur telefonata dhe me shkrim. Hamendja kanë ardhur zakonisht nga telefonatat, por e tregova edhe një rast ku me siguri nuk e dini të gjithë. Një ministri e caktuar në mbrëmje ka dërguar një shkresë ku ka bërë dy persona diplomatë dhe në mëngjes i ka larguar se nuk janë diplomat kemi pasur dhe kësi lloj. Për këtë arsye janë shumë të rëndësishme që ne si instucion të jemi gjithë përfshirës atë që jemi të sigurt ti vendosim ato që nuk jemi të sigurt i kemi filtrat e tjerë që mund ti largojnë. Zyra sipas përgjegjësisë që ka e bie pran jush një rekomandim, pastaj rekomandimi varet nga ju a votohet apo jo votohet edhe me ndryshime. Zyra ka kryer punën e vet nëse keni nevojë për shkresa shtesë duhet të ma specifikoni çfarë shkresa shtesë do të jenë dhe ne brenda një kohe të shkurtër gjitha ato shkresa shtesë që i kërkoni ju do i sjellim.

Sami Hamiti: Kryetare kërkoj që pas asaj që e tha Ylli që ka pasur telefonata që për ne nuk thonë asgjë, këtë e ke bërë ti me dikë të institucionit. Kërkoj që bashkërisht KGJK-s edhe kush e ka shpreh dyshimin. Prandaj edhe tani kërkoj zyrtarisht të confirmohen a janë ato lista të sakta.

Alim Rama: Unë këtu po e shoh një tendencë për ta vonuar procesin zgjedhor. Çdo shtyrje e këtij certifikimi sot ndikon në kalendarin zgjedhor, rrjedhimisht ndikon sepse çdo gjë shkon më tutje pastaj duhet të ndërrohet edhe dita e zgjedhjeve. A është problem këtu vet mbajtja e zgjedhjeve. Unë po e shoh një qëllim të caktuar prej disa kolegëve këtu që nuk po duan të mbajnë zgjedhje se me vet faktin që ndalohet apo shtyhet certifikimi i subjekteve politike, ku vetëm t`ju përkujtoj edhe për publikun që të

gjithë subjektet politike që kanë deputet në përbërjen e fundit ato certifikohen automatikisht. Kështu që ne as nuk kemi të drejt ti certifikojmë. Ne kemi qenë shumë të kujdesshëm se si organ në plan operacional ti ndjekim hapat e mjaftueshëm sipas ligjit për cilin do institucion edhe për cilin do institucion që mund ta ankohe në proces. Vet fakti që shtyhet dhe marrim një rol ekzekutiv i cili shqyrton dokumente është i pa pranueshëm është një praktik që kurrë nuk ka ndodhur në KQZ, e cenon procesin zgjedhor. Unë po shoh tendencë që të shtyhet procesi zgjedhor, momentin që ne nuk i certifikojmë sot ne nuk mundemi ta bëjmë shortin me të parin, rrjedhimisht nuk mund ta bëjmë shtypjen e fletëvotimit me të dytin, rrjedhimisht nuk mund të filloj votimi me postë të dytin. Rrjedhimisht ka për tu vonuar çdo proces. Kështu që unë vet besoj që edhe anëtarët e tjerë nuk jemi specialist dhe nuk jemi specializuar ti trajtojmë dokumentet e një zyre të specializuar. Ne me këtë rast po shpërfaqim një hamendje në profesionalizmin e ZRPP-s, për mua arsyetimi në pikën e fundit është shumë i qartë zyra ka hasur në vështirësi edhe unë desha t'ju rikujtoj se këto vështirësi nuk janë herën e parë. KQZ-ja në asnjë zgjedhje nacionale nuk ka mundur ti zbatoj këto ky është problemi edhe i legjislacionit në fuqi, tash i përmendëm dhe rastet banale edhe nëpër media që dikush për një gjobë 18 Euro, 20 Euro, 80 Euro. Ne nuk mundemi të dalim nga mbledhja pa e miratuar propozimin e KQZ-s dhe unë e mbështes rekomandimin e zyrës kështu që mbledhja nuk mundet të përfundoj sepse cenohen të gjitha hapat e planit operacional. Çdo vonesë ndikon në proces zgjedhor. Unë nuk e di cili nga ne i plotëson kushtet që të jetë zyrtar në ZRPP, unë nuk e di se cili nga ne jemi të kualifikuar për atë punë.

Ne, tha z. Rama, marrim vendime në bazë të rekomandimeve ne kemi pasur raste shumë më herët që nuk jemi pajtuar me departamente të caktuar të sekretariatit, por ne e kemi votuar nuk kemi kërkuar prej asnjërit të na tregoj se si ta zbatojmë ne i thamë Burimit a ke kapacitete të mjaftueshme, ne nuk i ndërhyem Burimit ti themi 100,150 a 500 kompjuterë ne ato nuk i thamë. E gjitha çka kërkuam nga Burimi ka qenë që ta zbatoj planin operacional të ketë kapacitete të mjaftueshme ta kryej një punë zyrtare. Ky është rekomandimi zyra ka hasur në vështirësi dhe ne boll mirë e dimë se kemi problem me Këshillin Gjyqësor të Kosovës. Ne duhet të vazhdojmë me certifikimin e kandidatëve dhe atë e kemi obligim ligjor ne vetëm një gjë e kemi para ligjit ti respektojmë të gjitha procedurat e KQZ-s, ti respektojmë rekomandimet dhe ti aprovojmë. Ne duhet ta votojmë se nuk kemi zgjedhje tjetër, ne nuk mundemi ti shqyrtojmë dokumentet a është në rregull përgjigja e KGJK-s, a është në rregull e Ministrisë së punëve të jashtme, a është përgjigja e AKI-s, e Policisë, e FSK-së. A na duhet tash duhet me shikuar edhe me i analizuar ato dokumente. A duhet edhe dikush forenzikën me marr aty kështu, që unë e ftoj KQZ-në që menjëherë të ja nis votimin e këtij rekomandimi.

Valdete Daka: Fornizika nuk na duhet për ta lexuar një shkresë fare.

Eshref Vishi: Proceduralisht, ne kemi propozimin e ZRPP-s. Ne duhet te procedojmë me rekomandimin për me ec ma tutje. Unë njëjtë propozoj që të qitet në votim rekomandimi...

Sami Kurteshi: Unë, përsëri se në fakt për herë të parë po e bëjë këtë të diskutojë këtu. Sot ne duhet ta marrim një vendim për këtë çështje dhe ta nxjerrim në votim edhe i kisha lut krejt kolegët që me duruar, me dëgjuar njëri-tjetrin. Ne nuk mund ta ndërpremë një mbledhje në asnjë mënyrë pa e marr një vendim sepse e kemi obligim kushtetues dhe ligjore. Ju kisha lut mos me ndërhy te njëri tjetri. Na gjithmonë mos pajtohemi tërë kohën. Por me ndërhy mos me ndërhy, të dëgjojmë kush është. Prandaj edhe unë kërkoj që edhe fjalët anash të lihen, është drejtpërdrejt personi, pajtohemi, s'pajtohemi, përgjigjemi, si përgjigjemi, është zyra këtu. Janë edhe organet tjera të KQZ-s. Unë po kërkoj ashtu siç e parasheh ligji, siç ka qenë praktika e mëparshme, ashtu siç është vepruar në këtë institucion mbrapa që rekomandimi i ZRPP-s, të votohet kështu siç është. Rekomandimi ishte me vend, të gjitha palët, gjithë personat, gjithë subjektet që mendojnë se janë të dëmtuara, si janë të prekura nga ne rekomandim i tillë. Edhe një vendim i KQZ-së i tillë e kanë të hapur rrugën ligjore ti ndjekin të gjitha hapat ligjor që ne të jemi brenda afateve të parapara në operacionet zgjedhore. Po dëshiron dikush të shoh dokumente të gjitha dokumentet afrohen, unë mendoj se asnjë dokument dhe kjo është kërkesa jon prej ditës së par, nuk ka dokument të prodhuar në KQZ që nuk është publik dhe ne kemi pasur problem me qasje.

Unë, si anëtar i KQZ-s kam pasur problem me qasje në dokumente, tash po kërkohen edhe dokumente që nuk janë të lejuara sepse kanë edhe të dhëna personale ky është një problem unë këtë nuk po e kuptoj. Si është e mundur mua mos të më jepet një letër ose kolegut tim që e ka dërguar KQZ-ja me një institucion tjetër sepse duhet të kalojmë në atë labirintin burokratik. Dhe tash kjo KQZ në bazë të një rekomandimi të një zyre të profesionalizuar kërkon dokumente që në të vërtet përmbajnë të dhëna që në të vërtet janë të ndaluara me ligjin për të mbrojturat e të dhënave personale, këtu e kam unë problemin pse tash për menjëherë, këtu është bërë zhurmë se ne si anëtar të KQZ-s kemi kërkuar një dokument që në të vërtet duhet të ishte publik edhe tash në këtë KQZ po kërkohen dokumente që në të vërtet nuk janë punë të KQZ-s. Ky ndryshim i kriterëve mua po më habit shumë, unë propozoj si anëtar i KQZ-s që rekomandimi i ZRPP-s të votohet të shkojmë më tutje dhe të hapen të gjitha komunikimet që janë mbajtur në KQZ qofshin në telefon dhe tash po ju bëjë ftes gjitha organeve që telefonatat, mesazhet tona që janë për ta nxjerr

këtë çështje ti marrin dhe ti publikojnë dhe gjitha mbledhjet që janë mbajtur në këtë institucion, jashtë këtij institucioni grupore në lidhje me këtë çështje e nuk janë ftuar gjithë anëtarët e KQZ-s por grupe, grupe të bëhen publikohen nuk kam asgjë kundër. Unë e ftoj AKI-n dhe Policin e Kosovës që më së pari në telefonin tim dhe nuk kam telefon tjetër që ta publikoj tërësisht çka është bërë por edhe gjithë këtyre këtu dhe jo vetëm disa dokumenteve. A po doni ta qojmë deri në skaj atëherë kjo është e mirë të bëhet unë jam për transparencë të plotë në lidhje me këtë çështje një e di dhe nuk po e bisedojmë sepse ne silllemi rreth një çështje por nuk i mëshojmë çështjes. Janë emra të caktuar për të cilët po mendohet për të cilët dikush është i interesuar ti lë apo ti dërgoj më tutje. ZRPP-ja ka dhënë një rekomandim, rekomandimi është ligjor bazuar në ligj dhe kushtetutë, i arsyetuar dhe unë propozoj që ky rekomandim të votohet dhe të hapet rruga për çështje ligjore ata që kanë vërejtje ata që duan ta sfidojnë rekomandimin dhe të dhënat e kanë rrugën e hapur por jo tash për këtë rekomandim të bëhen format dhe ti iket problemit kryesor të diskutohen rrugët kryesore të kërkohen gjëra që nuk janë kërkuar kurrë deri më tash, që nuk janë bërë deri më tash e tash po kërkohet. Edhe unë jam i bindur se në një moment të caktuar do të dalin edhe emrat konkret prandaj propozimi im për kolegët është ta zbatojmë ligjin, ta zbatojmë kushtetutën, ta respektojmë vendimin e zyrës dhe të ecim më tutje me procesin zgjedhor.

Arianit Elshani: Realisht për këtë kohë sa po biseduam e debatuam këtu ZRPP-ja ka mundur ti kompletoj dokumentacionet me këto që u kërkuan në fillim të mbledhjes. Realisht ne edhe si anëtar e kemi edhe një betim para presidentit Z. Thaçi dhe në njëfarë forme kemi edhe përgjegjësi penale në anën tjetër duhet ta kemi parasysh se kemi edhe ligjin që është miratuar nga këta deputet që ndoshta sot figurojnë në listat e gjykatës. Kështu që është mirë sepse ne këtu të gjithë kemi përgjegjësi edhe penale është mirë që të kemi parasysh këtë, askush nuk po e konstaton sepse e dimë që secila parti politike ka brenda listës së vet kandidat që ju është rekomanduar nga ZRPP-ja për tu zëvendësuar. Dhe askush nuk po e konstaton se ka vota për apo ka vota kundër apo do të votohet për apo kundër rekomandimit. Po ajo çka u kërkua është para vetes komunikimet që janë bërë me KGJK-n dhe institucionet e tjera. Andaj unë preferoj që mos të humbim kohë ti japim një orë, dy orë në dispozicion sa i nevojitet ZRPP-s ta sjell atë dokumentacion para gjithë anëtareve. E thash edhe nenin 30 që e qartëson faktin që anëtarëve të KQZ-s nuk ju mohohet e drejta për të pasur qasje në ato dokumente dhe do ti kemi para vetës dhe pastaj e diskutojmë dhe e marrim vendim. Realisht pajtohem edhe me Z. Rama që sot duhet të mbaroj kjo çështje dhe ashtu duhet të ndodh sot duhet të certifikohen por vetëm na bini shkresat përcjellëse.

Eshref Vishi: Ne, jemi në zbatim të planit operacional, jemi duke ecur na bazë të planit. Në këtë ditë e kemi ditën e certifikimit e kandidatëve për zgjedhje dhe zyra tregon se ka zbatuar rregullat dhe dispozitat ligjore. Ky rekomandim të hedhet këtu.

Yll Beleshkaj: Ligji na parasheh të qartë, edhe rregulloret tona edhe kërkesat që i ka KQZ-ja dhe që i ka zyra. Njëjtë edhe procedurën e punës të KQZ-së që është përgjegjëse kryetarja për ta zbatuar dhe për ta interpretuar. Edhe ne duhet me respektuar sepse atë e ka kompetencën. Ajo se çka e keni para jush është rekomandimi i zyrës. Secila korrespondencë që zyra ka pas raport të jashtme, kryetarja është në kopje. Ju nuk keni nevojë fare të kërkonit nga zyra, kryetarja është në secilin institucion që keni komunikuar, kryetarja është në kopje. Edhe nuk keni nevojë të zyra me lyp, është të arkiva këto dokumente. Nëse ka diçka tjetër që nuk jeni shumë të interesuar e që jeni të drejtë të gjykoni duhet me ndjek një procedurë e cila është thjeshtë, qartë e paraqitur në rregulloren e punës së KQZ-së. Rekomandimit e zyrës votohen ose nuk votohen ose ndryshohen. Por këto tendencat e ndryshme është mirë me i lanë anash, na kemi rekomandim aq sa jemi profesional. Nuk pretendojmë që jemi më profesional se Gjykata supreme, për këtë arsye kemi cek që gjyqtarët dhe gjyqtarët e PZZA-it edhe vetë gjyqtarët e supremes, mundën me korrigjue në qoftë se zyra ka lëshuar ndonjë gabim. Ne e kemi dhanë mundësinë partive politike vullnetarisht ti ndërrojnë kandidatët e vet ndërsa për të tjerët ne e rekomandojmë kështu. Për gjithçka çka keni në dokumente kryetarja është në CC, mundeni me i kërkuar nga kryetarja, por mundeni edhe nga zyra vetëm na tregoni.

Valdete Daka: Faleminderit Yll. Është e vërtetë që të gjitha rekomandimet ose duhet të votohen ose mos të votohen mirëpo mund të kërkohen shpjegime. Unë, nuk po them që nuk do të votohen po do të votohet. Por kërkesa është që të kemi shpjegime është e vërtetë se unë i kam ato korrespondenca mirëpo duhet një afat që ato korrespondenca të shpërndahen edhe tek anëtarët e KQZ-s dhe pastaj të vendosim se çka dhe a do të votohet dhe si do të votohet dhe çka do të votohet

Alim Rama: Kjo kërkesa e juaja është pak një shkarje prej rregullave të KQZ-s ne e kemi një rekomandim që e ka rekomanduar edhe kolegu Vishi. Ne duhet ta votojmë këtë rekomandim tash secili prej nesh na takon ku mundet ta shikoj gjithçka por ne nuk mundemi ta ndërprejmë këtë mbledhje pa e votuar këtë listë. Tash secili ka votën dhe bindjen, unë e kam bindjen time plotësisht të pajtueshëm me ligjin dhe e përkrahi rekomandimin e zyrës. Kush ka bindje tjetër mundet të votoj ndryshe, mund ta përmendim PZAP-in dhe këta të tjerët është një procedurë, zingjiri kështu që ne duhet të vazhdojmë me votim. Kështu që

ne kemi pasur rekomandim, është procedurë e KQZ-s nuk mundemi të bëjmë përjashtime çdo herë që nuk na pëlqen rezultati në lojë. Sepse është një tendencë që duhet të ndërrojmë diçka. Ju lutem një rregullore, vendimi siç ka qenë nuk janë zgjedhjet e para as të fundit besoj. Kështu që të vazhdohet me këtë pastaj janë afatet e tjera janë afatet ligjore, për çdo proces kemi të drejtën ta shfrytëzojmë. Kështu që të shkojmë në votim dhe ta përfundojmë këtë.

Valdete Daka: Faleminderit Alim për sqarimet. Ashtu siç je ti i bindur që rekomandimi është i bazuar në ligj, dhe beson se ai rekomandim është i bazuar në ligj ka anëtar që besojnë se ai rekomandim nuk është i bazuar në ligj. Na jepni kohë dy orë që ne të përfundojmë aplikacionin dhe ua shpërndajmë të gjithë anëtarëve dhe pas dy ore takohemi. Pa pasur dokumente shtesë për këtë vendim ne nuk mundemi ta qesim në vendim. Unë propozoj që kjo mbledhje të shtyhet për dy orë deri sa ti përgatisim të gjitha dokumentacionet me qenë se ato dokumentacione i kam unë, do ti përgatis zyra ime do ti përgatis këto dokumentacione do jua shpërndajmë të gjithë anëtarëve dhe pastaj do të mblidhemi dhe do të vazhdojmë pikën e rendit të ditës e ajo është certifikimi. Nëse pajtohemi të gjithë.

Sami Kurteshi: Ne i dëgjuam gjërat, dolën dhe gjëra të reja të shtyhet mbledhja për më vonë sepse paska anëtar të KQZ-s që nuk janë të bindur. Unë mendoj se bindjen tonë e shprehim duke pasur parasysh përgjegjësin penale, sepse u përmend përgjegjësia para ligjit, para kushtetutës dhe ne me përgjegjësi penale me votën tonë e dëshmojmë. Ai që mendon se është kundër voton kundër që mendon se duhet me rekomanduar, ne e dimë që nuk doni ta votoni sepse po e shohim. Por unë mendoj që secili prej nesh e ka pasur parasysh përgjegjësin penale dhe ligjore kur është bërë anëtar i KQZ-s edhe ne nuk kemi pasiguri në këtë aspekt, nëse dikush paska nevojë për konsultime shtesë sepse nuk e din cilin vendim ta merr, urdhëroni. Por unë kërkoj që të votohet për rekomandimin e zyrës tani dhe të hapet rruga ligjore për të gjitha çështjet, sa i përket natyrës ligjore dhe kushtetuese ne e kemi obligim ta votojmë pro, kundër me abstenuar dhe ta kryejmë këtë çështje dhe ti fillojmë procedurat e tjera.

Alim Rama: Sipas ligjit, nenin 26.1, zyra i bënë një rekomandim të shkruar KQZ-s. Unë askund nuk e pash në ligj që KQZ-ja bënë shqyrtimin në ligj por KQZ-ja vendos për rekomandimin e zyrës. Kështu që unë jam që KQZ-ja ta respekton dhe zbaton ligjin dhe tua lejon institucioneve të tjera ZRPP-ja është institucioni i cili i ka përgjegjësit për zgjedhje, kështu që ne si KQZ nuk kemi të drejt t'ia marrim ato përgjegjësi ato përgjegjësi i ka me ligj. Unë e thash ne e kemi vlerësuar drejtorin e zyrës me notën maksimale që askush nuk e ka marr më herët. Zyra ka një autoritet të vetë, zyra vepron me përgjegjësi juridike dhe kemi një

rekomandim rregulloret në fuqi të KQZ-s votojnë pro apo kundër. Secili nga ne me bindje të plotë duhet të votoj pro ose kundër rekomandimit të zyrës atëherë nuk mundet mbledhja të ndërprerët kështu që unë ju kërkoj që ta hidhni në votim siç e keni në bazë të rregullores dhe atëherë secili të shprehet veç e veç.

Valdete Daka: Ne, kemi të drejt ti shohim dokumentet, kemi të drejtë të dimë për çka po votojmë secili prej anëtarëve dhe kemi përgjegjësi juridike dhe morale dhe dëshirojmë të dimë të sigurt për çka votojmë. Duam ti shohim të gjitha dokumentet këtë ua mundësojmë.

Sami Kurteshi: Edhe kjo është një informatë shumë e vlefshme ne kemi të drejt ti shohim ato dokumente sepse nuk i kemi parë deri më tani. Pse qenka vetëm kryesuesja e KQZ-s si organ kolegjal që i paska ato dokumente dhe ne si anëtar të KQZ-s nuk i paskemi. Cila qenka arsyeja? Unë jam anëtar i KQZ-s, ju deklaroni vetë se jemi organ kolegjal, ju e keni ti kryesoni mbledhjet po për dokumente të KQZ-s pse ne nuk i paskemi dhe nuk i dimë gjithë ato dokumente. A kam të drejt ti kem edhe unë ato dokumente si anëtar përveç atyre që janë personale të tuat, ato dokumente të KQZ-s. A është e drejt ligjore dhe obligim ligjor i administratës së KQZ-s dhe e drejt e anëtarëve të KQZ-s që të kenë qasje në dokumentet që janë të KQZ-s dhe pyetja ime është tash si paska qenë e mundur që ne mos te jemi të informuar në këto dokumente kur qenkan të qasshme, publike dhe vetëm një anëtar i KQZ-s paska qenë, kjo është pyetja ime çka ndryshoj tash.

Valdete Daka: Nuk ndryshoj asgjë kreu i institucionit është gjithmonë siç është kryshefi jo për të gjitha dokumentet por kreu i instituicionit është gjithmonë.

Sami Kurteshi: Aty është një institucion që e udhëheq dhe është avokati i popullit në cilësinë e kryetarit. Kryesuesja e KQZ-s është anëtare e një kolegji me të drejta të barabarta me një përparësi të përfaqësimit dhe të udhëheqjes së mbledhjeve po me asnjë përparësi tjetër.

Valdete Daka: Ne, edhe më herët kemi kërkuar nga zyra dokumente për ndonjë problem që kemi hasur në zgjedhjet e mëparshme, edhe për regjistrimin e ndonjë partie por edhe për diçka tjetër.

Alim Rama: Kushdo që dëshiron dokumente shtesë mundet të shkoj tek zyra dhe ti marr, por ne kemi punë ta votojmë ne jemi këtu të votojmë në bazë të ligjit.

Vazhdim i mbledhjes...

Valdete Daka: Atëherë, vazhdojmë aty ku kemi mbetur...! Ne, e shtymë pikën e rendit të ditës, meqenëse na ishte e nevojshme të kishim edhe disa shkresa, të cila unë i kam pa por të tjerët jo. Dhe sa për informatën e z. Kurteshit, unë i nënshkruaj të gjitha shkresat në emrin e KQZ-ës, prandaj dhe me dërgohen që ti shoh. Meqenëse u ngritën dilema, dhe mëdyshje lidhur me shkresën e KGJK-ës, i cili është një organ i pavarur i Republikës së Kosovës, te cilit zyra ja ka dërguar një kërkesë që të behet verifikimi i kandidatëve të cilët kanë akt gjykime të plotfuqishme. Kam kërkuar që të na tregohet që a kanë qenë këto shënime të sakta dhe a kanë gabime:

“I nderuar Z. Maliqi ju lutem na konfirmoni se a janë të sakta shënimet të cilat ja keni dërguar drejtorit të ZRPP-s dhe certifikim, z. Yll Buleshkaj me datën 20 janar 2021, lidhur me verifikimin e candidateve nga lista e KQZ-ës për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës”.

Pra, kjo është shkresa të cilën ja kam dërguar, dhe përgjigjja e cila na ka ardhur është kjo:

“E nderuar bazuar ne kërkesën e KQZ-ës të datës 18 janar 2021 të kërkesës se datës 21 janar 2021 për verifikimin e candidateve për deputet për zgjedhjet parlamentare të datës 14 shkurt 2021 ju informoj si në vijim. Verifikimi i candidateve është bërë ne bazë të dhënave të cilat i disponon data baza qendrore e evidencës penale pran sekretariatit të KGJK-ës, ne këtë data bazë regjistrohen të gjitha aktgjykimet e plotfuqishme penale nga gjykatat e vendit, dhe në këtë data bazë regjistrohen të gjitha sanksionet penale të shqiptuara me aktgjykim të formës së prerë, lidhur me procesin e verifikimit paraprakisht kemi kërkuar konfirmim nga të gjitha gjykata e vendit të na konfirmojnë me shkrim se të dhënat e proceduara ne sistem janë të sakta rrjedhimisht ne kemi marr konfirmimet për saktësinë e të dhënave dhe faktin që të gjitha dënimet e plotfuqishme janë proceduar në sistem. Për çdo sqarim apo ndonjë rast konkret që ju mund të keni dyshime për saktësinë e të dhënave, ju lutem të na drejtoheni me shkrim dhe menjëherë do të merrni përgjigjen. “

Kjo, është pra shkresa e cila na është dërguar me kërkesën time, meqenëse nga drejtori i zyrës u ngritën mëdyshje lidhur me saktësinë e shënimeve të cilat janë dhen lidhur me verifikimin e candidateve sa i përket nenit 29, pika Ç të ligjit për zgjedhjet e përgjithshme. Gjithashtu bashkangjitur i keni edhe shënime edhe shkresat tjera, pra është shkresa e cila ju është dërguar Këshillit Gjyqësor me datën 18 janar, dhe është kërkuar që të verifikohen kandidatet se a janë gjyqtar së pari, a ka kandidat ne listën e pranuar nga

KQZ-ja se janë subjekt i vendimit të gjykatës me të cilin i është hequr e drejta për të qenë kandidat dhe a janë të shpallur fajtor për vepër penale më një vendim përfundimtar të gjykatës në 3 vite e fundit nga data 7 janar 2018 e deri me sot. Ne këtë shkresë janë përfshirë 47 emra nga 15 subjekte, bashkangjitur përsëri keni shkresat e zyrës për regjistrim të partive politike dërguar subjekteve respektive, pra kërkesa i është dërguar subjektit PREBK qe thotë:

“I nderuari z. Muhamedali me shpalljen zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Kosovës nga ushtruesja e detyrës se presidentit e Republikës së Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhje ka ndërmarre të gjitha hapat për certifikim të subjekteve politike dhe kandidateve të tyre për pjesëmarrje në zgjedhje të parakohshme për Kuvendin e Kosovës që do të mbahen më 14 shkurt 2021. Me autorizimet që dalin nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës ligji për zgjedhjet e përgjithshme dhe rregullat e KQZ-ës, secili kandidat duhet të verifikohet nëse ka ndalesa që do të ja bënë të pamundur për tu paraqitur si kandidat për deputet. Neni 29 i ligjit për zgjedhje e përgjithshme përcakton se kandidat për deputet nuk mund të jetë askush që me anë te vendimit të gjykatës i është hequr e drejta për të qenë kandidat apo që është shpallur fajtor për vepër penale më një vendim përfundimtar të gjykatës ne 3 vitet e fundit. Në frymën e obligimeve kushtetuese dhe ligjore më 18 janar 2021, KQZ-ja i kërkoj Këshillit Gjyqësor të Kosovës që t’i siguroj emrat e individëve nga lista e kandidateve për deputet për Kuvend të Kosovës që me anë të vendimit të gjykatës i është hequr e drejta për të qenë kandidat apo që është shpallur fajtor për vepër penale më një vendim përfundimtar të gjykatës në 3 vitet e fundit, me 20 janar 2021 KQZ ka pranuar nga KGJK shkresën në të cilën janë identifikuar për kandidatet tuaj si me poshtë, për korrektësi nuk do ti lexoj emrat, janë 5 kandidat. Rrjedhimisht nëse jeni i interesuar subjekti i juaj politik për kandidatet e cekur me lart mund të dërgoj zëvendësimin të gjinisë së njëjtë deri më 21 janar në ora 13:00 në zyrë.”

Kjo, shkresë e njësoj vetëm me emra të ndryshëm dhe me emra të partive të ndryshme i është dërguar 15 subjekteve të cilat kanë pasur kandidat, emrat e të cilëve janë dërguar me shkresën e KGJK-ës. Po ashtu, kemi dhe shkresat e institucioneve të tjera të cilat janë dërguar në Ministrin e Punëve të Brendshme, ku është kërkuar, dhe kërkesa titullohet: “Kërkesë për Konfirmimin e Përputhshmërisë Juridike me nenin 29 të listës së kandidateve për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës”. Shkresë, i është dërguar agjencisë së Kosovës për inteligjencë, i është dërguar edhe Doganës së Kosovës, i është dërguar edhe Ministrisë së Punëve të Jashtme. Pra, këto janë shkresat të cilat janë dërguar dhe janë marr pastaj dhe përgjigjet. Ministria e Punëve të Jashtme e cila fillimisht e ka dërguar shkresën përsëri për shkaqe të korrektësisë, ka dërguar shkresën se dy nga kandidatet nga lista zgjedhore AAK:

“Referuar shkresës së juaj të pranuar ne Ministrin e Punëve të Jashtme në harmoni me nenin 15 të ligjit nr.03L073 për zgjedhjet e përgjithshme me lejoni që te ju informoj lidhur me emrat dhe pozitat e kandidatëve që janë pjesë e MPJD-ës e të cilave do të jenë pjesë e listave zgjedhore...”

Pastaj, është bashkangjitur edhe vendimi për pezullim të marrëdhënies së punës dhe shkresa tjetër e cila ka ardhur pas një ditë dhe ka thënë që 4 persona të cilët janë pjesë e listës AAK-ës, nuk janë përfaqësues diplomatik, pra kjo është shkresa e cila ka ardhur nga Ministria e Punëve të Jashtme pastaj ka ardhur shkresa nga AKI, ku thuhet se, asnjë nga kandidatet nuk është punonjës i agjencisë të Kosovës, pastaj ka ardhur shkresa nga Këshilli Prokurorial ku thuhet se, asnjë nga kandidatet nuk është prokuror, pastaj ka ardhur shkresa nga Ministria e Financave, pastaj edhe nga Doganat, por që është një kandidat dhe për të njëjtin, është bashkangjitur vendimin mbi pezullimin e marrëdhënies së punës dhe është bashkangjitur edhe ai vendim...!

Këto, tha në fund znj, Daka, janë shkresat të cilat na janë kthyer dhe përgjigjet që na janë kthyer nga institucionet nga të cilat kemi kërkuar verifikimin i kandidatëve. Pra këto janë te gjitha shkresat dhe pastaj i kemi subjektet politike. Kisha dashtë ta di nga Z. Buleshkaj sepse, këtë nuk na ka than, se, cilat nga subjektet të cilat kanë aplikuar për certifikim, kanë bërë zëvendësimin e kandidatëve ashtu siç është kërkuar.

Ylli Buleshkaj: Për hir të korrektësisë edhe një herë po dua me cek që zyra nuk e ka dërguar vetëm për kandidat të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës po ashtu edhe për PDK, kanë qenë dy subjekte politike. Janë disa subjekte politike të cilat vullnetarisht i kanë tërhequr kandidatet aty përfshihet Lidhja Demokratike e Kosovës me një kandidat, PDK-ja me një kandidat që e ka pasur dhe e ka zëvendësuar me një tjetër, PRBK, po ashtu dhe Lista Serbe e ka ndryshuar, ka ndryshuar VATANI. Prej atyre 47 nga ata kanë mbetur ne listë edhe 26. Një subjekt politik me zëvendësimin që e ka bërë prapë edhe ai është në listën tjetër të KGJK-s. Kemi nga ata që nuk i kanë zëvendësuar nuk i ka zëvendësuar PAJ, NISMA nuk i ka zëvendësuar, kemi AAK-ja që nuk i ka tërhequr, dhe ka bërë kërkesë që të ju rishqyrtohet njoftimi sepse kandidatet të cilët nuk janë të listuar nuk është e vërtet nuk janë vepra penale por janë vepra e llojit tjetër. Nga këta që jemi këtu nuk i ka zëvendësuar NISMA, AAK-ja, LVV-ja, PAJ. Ne i kemi jep listat për ata që janë të konfirmuar subjektet politike dhe i kemi bashkangjitur me rekomandim për secilin subjekt politikë. Një raport të shkurt për ata që nuk i kanë zëvendësuar por nuk e di sa qon peshë proceduralisht kur ta shohim këtë punë kur e dimë se sipas nenit 11 nga pika e propozuar nga njësia e propozuar pas pyetjeve votohet

ashtu siç është ose kalon ose nuk kalon. Por nëse ka nevojë për sqarime shtesë dhe te detajshme një pushim të shkurt mundem më ja jep, edhe pse proceduralisht nuk e di se sa qëndron kjo.

Sami Kurteshi: Unë nuk paska pas nevojë me i lexuar këto sepse i dëgjova tani, sinqerisht edhe nuk jam i interesuar ta luaj rolin e administratorit të zyrës apo referentit sepse për këtë e kemi një zyre si duket po deklarom që më përgjithësi ligjore e merr përsipër këtë detyrë dhe e ka marruar përsipër këtë detyrë dhe unë këtu sa i dëgjova gjitha këto nuk dëgjova diçka të re që qon në drejtim të mungesës së vendim marrjes. Zyra ka bërë një rekomandim, ky rekomandim i ZRPP-s duhet të dal në votim, urdhëroni votoni, secili e ka të drejtën e vet që të votoj ashtu se si donë. Nëse ka diçka tjetër që nuk qenka e qartë. Unë propozojë dhe kërkoj që zyra, rekomandimi i zyrës me dal me votim.

Sami Hamiti: Njoftim ne lidhje më përputhshmërisë juridike me nenin 29, për zgjedhjet e përgjithshme, ju ke treguar që nuk është në përputhshmëri, a i ke than a doni të zëvendësoni apo nuk doni të zëvendësoni po ti i ke treguar që nuk është në përputhshmëri me nenin 29 të ligjit, prandaj unë e kam kërkuar shkresën që ta lexoni.

Arianit Elshani: Po mendojë që e para është mirë më i shpërnda listën e atyre subjekteve që i kanë dorëzuar dhe nuk i kanë dorëzuar, ne nuk i kemi informatat e plota. Do më than i kemi informatat dhe është mirë që kush do që nuk i ka para vetës dorëzoi dhe secili të jetë i informuar le të jetë edhe opinionin publik i informuar se kush i ka dorëzuar dhe kush jo. Kështu që angazhoni administratën apo vet që të përgatisni këtë listë të subjekteve politike të cilët i kanë përmirësuar, kjo është kërkesa.

Eshref Vishi: Të gjitha këto shkresa të cilat na erdhën neve, tregojnë që ka ndodhur një komunikim intern në mes të KQZ-ës dhe ZRPP-s dhe institucioneve relevante të cilat apostrofohen në nenin 29 për të siguruar informacionet të cilat ne veç i kemi para vetës, proceduralit janë çështje dhe punë të ZRPP-s dhe si rezultat i këtyre komunikimeve kemi rekomandimin. Nuk po e shoh të arsyeshme që të zhagisim këtë çështje mirëpo rekomandimet prapë propozova dhe me herët, është mirë që të dalin në votim dhe te shohim rrjedhën e këtij procesit.

Valdete Daka: Do të dalin në votim, por do të dalin ne votim secili subjekt veç e veç. Sepse ne nuk mundemi të votojmë në paket. Secili subjekt politik i ka specifikat e veta dhe nuk i kemi votuar e asnjëherë deri me tani në paket për certifikim subjektet politike e as kandidatet e tyre. Ashtu siç kanë ardhur

aplikimet nga dita e parë deri në ditën e fundit i kemi edhe partitë politike edhe iniciativat qytetare të cilat kanë aplikuar për certifikim dhe ashtu do të votohen secila veç e veç.

Ylli Buleshkaj Do të thotë që ju nuk i përmbani rekomandimet po ju përmbani një listës që e keni bërë ju apo si.

Valdete Daka: Ne rekomandimin e kemi dhe aty janë të listuar të gjitha partitë nga një nga një dhe ashtu do i votojmë.

Alim Rama: Unë jam i shqetësuar nga kërcënimi që beri Z. Hamiti drejtorit të zyrës, po ashtu kam ndjenja që ajo vjen edhe nga ju deri diku. Unë mendoj që ne kemi një rekomandim dhe nuk na takon neve që të luajmë rolin e referentit ajo është puna e zyrës të cilën e ka zbatuar, e kemi një rekomandim dhe praktika ka qenë këtu edhe me herët që për shkaqe që të votohen në paket. Dhe unë dua ta lexojë qartë rekomandimin e zyrës i cili duhet të jetë në votim, zyra ka hasur në vështirësi për të pasur një qëndrim të qartë lidhur me zbatimin e shkronjës Ç të nenit 29 të ligjit për zgjedhje për arsye të pa qartësisë, zyra rekomandon KQZ-ën që të certifikojnë në pako subjektet politike dhe kandidatet e mësipërm, certifikimi i kandidateve liron KQZ-ën nga obligimi i cili rrjedh nga neni 30 LPZ-ës ne lidhje me ruajtjen e informatave që janë të identifikuar nga instucionet e tjera, dua ju krijuar mundësi palëve të interesuar të bëjnë ankesa në intonacionin e shkallës së par dhe të dytë. Rrjedhimisht zyra rekomandon certifikimin e 28 subjekteve politike që kanë aplikuar për certifikimin dhe kandidateve të tyre, ky është rekomandim praktika ka që gjithmonë, rekomandimet e zyrës ose sekretariati të votohen ashtu siç janë, ajo është votimi i parë.

Valdete Daka: Tani unë po e lexojë nenin 26 të ligjit për zgjedhjet e përgjithshme, i cili thotë: Shqyrtimi i listës së kandidateve, titulli i nenit është 'neni 26 pika 1': zyra i bënë një rekomandim të shkruar KQZ-ës për ose kundër certifikimit të secilës listë të kandidateve të pranuar jo me vonë së 5 ditë punë pas afatit për dorëzim të listës. Secilës listë veç e veç.

Sami Kurteshi: Ne, e kemi sepse nuk po e di a po e lexojmë të njëjtin, zyra e paraqet rekomandimin më shkrim KQZ-ës për ose kundër certifikimit e listës së kandidateve brenda 10 ditëve të punës pas dorëzimit të njoftimit sipas nenit 26. Pra jemi duke lexuar të njëjtin ligj, nëse ky është ligji, po unë po dua diçka tjetër me than është e para, presioni i hapur mbi ZRPP, nga zonja Daka, nga përfaqësuesi i LDK-ës dhe nga përfaqësuesi i PDK-ës, për selektim negativ të listave të kandidateve edhe ne dalëngadalë po rrëshqasim

në binaret e krijimit të selektimit diskriminues të partive politike të listave të kandidateve, kjo duhet të duket qartë. Zyra për regjistrimin e partive politike si organi kompetent brenda KQZ-ës, e ka bërë një rekomandim meqenëse dikush dëshiron që ta pengojë dhe bënë presion drejtë për drejtë në zyrën. Ne edhe njëherë kërkojmë që rekomandimi i zyrës të dal në votim dhe të votohet unë po e shoh hapur tendencën edhe kjo po shihet hapur se ekziston një tendencë e selektimit negativ në secilin veç e veç dhe ne tani ta votojmë dikën për e dike jo.

Valdete Daka: Ja ku është ligji neni 26 'shqyrtimi i listës së kandidateve, pika 1, neni 26 paragrafi 1, zyra që i bëjnë një rekomandim të shkruar KQZ-ës për ose kundër certifikimit të secilës listë të kandidateve të pranuar jo më vonë se 5 ditë punë pas afatit për dorëzim të listave.

Sami Kurteshi: Mua, po me duket shumë e pa drejtë kjo ndërhyrje...! Edhe përpjekja për eliminim politik të partive të caktuara edhe të listave të caktuara kjo është, ne i kuptojmë rrethanat politike e kuptojmë të gjithë tendencën, e kuptojmë çështjen që është procesi zgjedhor, preferencat e qytetareve, mirëpo unë po ju them hapur kjo është tendencë e vendeve autoritare për mënjanimin e kandidateve sidomos të kandidateve të votuar me së shumti me besueshmëri më të madhe qytetare në Republikën e Kosovës Kjo është tendenca dhe ne tash po dalim sa për informim. E dyta, u ndërpre mbledhja e parë me kërkesën e përfaqësuesit të LDK-ës dhe të PDK-ës, jo me të tjerat ne e kundërshtuam, mirëpo vlera për kryetaren e KQZ-ës, vlera e këtyre dy partive është shumë me e madhe dhe urdhri i tyre është më i madh sepse ne ishim kundër, tani përsëri po kërkohet dhe përsëri do të kërkohet që të behet eliminimi i kandidateve edhe eliminimi i listave të partive politike në mënyrë të qëllimshme, por tani duhet ta themi hapur nga kush dhe si. Unë po kërkoj edhe një herë që të votohet rekomandimi i zyrës për regjistrimin e partive politike si organ kompetent brenda KQZ-ës dhe secili e ka të drejtën e votës sipas ndërgjegjes apo sipas direktivave apo si do qoftë, unë si anëtar i KQZ-ës kjo është kërkesa ime pa selektim negativ pa diskriminim pa përpjekje për eliminim.

Valdete Daka: Secili nga ne, e kemi dhënë betimin këtu që kemi më respektuar ligjin dhe kushtetutën.

Arjanit Elshani: Kam një propozim. E para, nuk është korrekte dhe para subjekteve politike të cilat i kanë bërë zëvendësimet dhe të atyre që realisht kanë pasur lista të pastra. Andaj rekomandoj që ti futemi secilës listë veç e veç ashtu siç keni bërë edhe në të kaluarën, në të kaluarën është votuar veç e veç jo për shkaqe që kanë pasur dëshirë, po për shkaqe që e thotë ligji ashtu, ligji e përcakton që secila duhet të

miratohet veç e veç, mos shikoni mundësit që janë krijuar vetëm për sot shikoni edhe atë që do të lejme edhe pas për zgjedhjet tjera. Ky është propozimi që ti votojmë veç e veç secilën të gjitha ato rekomandime ashtu si janë Z. Buleshaj duhet ti trajtojmë, do i qesim në votim secilën! Hiq pa merak, në bazë të propozimit si ka propozuar ai ashtu veç e veç të pastra e të papastra, do të votojmë secilën listë - të pastër ose të papastër. do ti qesim në votim e hedhim në votim secilën.

Pra, tha z. Elshani, shkoni ashtu se si kanë aplikuar ose ndani ne tre rangje, ne rangun e parë listat e papastra, listat të cilat kanë bërë përmirësimin dhe listat të cilat nuk kanë bërë përmirësimin. Z. Buleshkaj, sot me veprimin tënd dhe me dërgimin e kësaj liste ke bërë veprimin më të rend dhe atentat kundër demokracisë dhe shtetit ligjor. Në fakt, t'i edhe ata që të kanë shtyrë me sjellë këtë rekomandim sot keni tentuar vërtet me bërë një atentat të demokracisë dhe sundimit të ligjit në Kosovë. Sot, t'i z. Buleshkaj ke vendosur që përgjegjësin institucionale dhe ligjore ta zëvendësosh me lojalitetin dhe simpatinë tende politike dhe këtë në kundërshtim të hapur me ligjin. Por, t'i nuk mundesh me u fshihesh nga përgjithësia e jote ligjore për këtë veprim. S'i u bë që, brenda 24 orëve ke ndryshuar interpretimin e certifikimit të listave? E potenco i edhe kryetarja: realisht, shkresat i ke dërguar të gjitha partive politike, kërkesa për dërrmimin e kandidateve që kanë qenë të dënuar ne tre vitet e fundit në pajtim me aktgjykimin të Gjykatës Kushtetues. Ja ku është shkresa juaj z. Buleshkaj që i ke dërguar Partisë Demokratike të Kosovës dhe, që e ka zëvendësuar brenda afatit kohorë të cilin, t'i e ke përcaktuar dhe nuk je kanë në gjendje as me shty për një orë.

A janë informuar partitë politike më shkresë? Sepse asnjëri nga partitë politike nuk është informuar për këtë. Cila, është arsyeja që ke ndryshuar qëndrimin kaq shpejtë ? A je kërcënuar ? A je shantazhuar ? A të është ofruar ryshfet, çfarë ka ndodhur që t'i personalisht kaq shpejtë me ndryshuar qëndrimin brenda 24 orëve ? Sepse, unë besoj që ti personalisht nuk e ke sjellë këtë rekomandim... !

Sot, veprimi yt është sulm direkt kundër sundimit të ligjit ne Kosovë, është sulm kundër demokracisë dhe vetë Republikës në Kosovë. Mira njerëz, kanë dhënë jetën që ne të jetojmë në një vend demokratik dhe ligjor, mijëra të tjerë kanë vuajtur burgjet për të pasur këto institucione që i kemi sot ? Sot, ky veprim i yti dhe i atyre që kanë detyruar në këtë veprim, po ja bënë shërbimin me të mirë armiqve të Kosovës. Sepse vendimi që i shkel te gjitha hallkat e ligjshmërisë në Kosovë është vendim që dëshmon një shtet jofunksional ashtu siç na quajnë armiqtë e Kosovës.

Z. Buleshklaj, a je i vetëdijshëm për këto që po tenton me bërë me këtë rekomandim që e ke sjellë ? Kështu që, unë ju ftoj të gjithëve që të mos i aprovojmë listat të cilat brenda tyre kanë njerëz të cilët janë listuar edhe nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, i miratojmë ato që janë me përmasime dhe ato të cilat realisht kanë sjellë lista të pastra. Andaj, edhe një herë ftoj që te i karakterizoni subjektet politike, është

mirë që opinioni publikë ta dinë fare mirë se cilat janë ato subjekte politike që kanë lista të pastra, ato të cilat i kanë përmirësuar. Për shkaqe të diskutimeve gjerë e gjatë që janë bërë në media ky ka kaq e ky kaq anëtar dhe këta janë deputet e këta jenë kandidat të cilët janë të listuar për hire të transparencës, është mirë edhe që të i listoni edhe hynë në format të tillë. Po kështu, siç i ke ofruar listat me emrat dhe mbiemra t'i futemi secilin veç e veç...! Faleminderit shumë...

8. Për pjesa për konfirmim përputh mërisë juridike me shkronjat A dhe Q të nenit 29, bënë me shquare datën 7 janar nga e cila datë edhe rrjedh kërkesa e secilit kandidat për deputet të ketë pastërtinë dhe unë mendojë që kjo datë duhet të jetë data e ditës së certifikimit dhe duhet të ndërrohet data 7 janar nuk duhet të lihet me ditën e shpalljes së zgjedhjeve kur edhe fillon procesi i verifikimit të deputetit, se a ka ndonjë vepër penale e cila bën në kundërshtim me ligjin. Po nëse duhet të ndërrohet data si datë dhe duhet të votohet kjo është e para. E dyta, nuk mundemi ta cilësojmë në listën që a është e pastër apo jo, do me thënë jemi në proces dhe jemi në vendit tonë që kemi krijuar vet ligjet dhe kemi mekanizmat të cilët kanë për ta qartësuar për secilin kandidat për deputet, qoftë PZAP-ja apo Gjykata Kushtetues, në këtë mes përfaqëson interesin e subjektit tim politik që është Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, dhe unë jam i mendimit sikur edhe Eshrefi, që të votohen rekomandimet të cilët janë nga zyra dhe secila përgjithësi dhe secili subjekt politikë le të vazhdojë tutje më procedurat si janë të parapara më ligj.

Sami Hamiti: Një vendim i kushtetueses ka ardhur si pasojë e një vendimit të një Gjykatës, ajo gjykatë është e Kosovës dhe është ra një qeveri. Jemi duke shkuar më këtë element saktë duke shkuar në atë rrugë zingjirore po edhe është duke u kundërshtuar. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese më së shumti e ka goditur subjektin tim por ne e kemi pranuar sepse është institucion, duhet që të ju binden të gjitha institucionet të Republikës së Kosovës. Ai diapozitiv i atij aktgjykimit na ka obliguar që të përfilllet neni 29, nuk është në çështje tona. Kemi ne edhe një shkresë në vitin 2017... Nuk kanë ardhur më certifikim atëherë... Janë certifikuar sepse ka ardhur vendimi.

Unë, po i referona vendimit të Gjykatës Kushtetuese, një qeveri ka ra për një aktgjykim dhe pikërisht ai gjykim i Gjykatës Kushtetuese na ka obliguar që të përfilllet neni 71 ndërlidhur më nenin 29 të ligjit për zgjedhje, unë si përfaqësues dhe si anëtar i KQZ-ës, listat në të cilat ka ende kandidat të cilët pavarësisht të cilit subjekt politikë nuk do ti votojë sepse është e qartë që voton kundër një aktgjykimit, e ka sjellë institucionin më i lart dhe ndoshta nuk pajtohet dhe kështu e konsiderojmë dhe mendojë që është e drejt që një aktgjykim i Gjykatës Kushtetuese na obligon që të veprojmë sipas ligjit. Prandaj subjektet politike gjithmonë janë votuar një nga një, kandidatë janë votuar një nga një dhe për deputet listat e subjekteve...

Ylli Buleshaj: Një gjë mundem me than lutja e rolit të prokurorit dhe të gjyqtarit nuk është që dërgon peshë te unë, se nëse veç kishte qar peshë do të kishim marr një vendim që i kishte pëlqyer ndoshta të gjithëve po do të kishte qenë kundër ligjit. Kjo është një punë që ne ë kemi përfunduar si zyre e kemi jep një rekomandim, zyra në asnjë rast nuk ja lejon vetes më i quajtur lista të pastra dhe të papastra sepse nuk është në kompetencë të zyrës me i quajtur lista të papastra gjithë ata janë personal të gjithë ata kanë mundur të kenë ndonjë konflikt, ndonjë aksident apo diçka të tillë dhe pastaj unë nuk mendojë që ai person është i papastër. Është këtu një bindje që e votojë KQZ-ja dhe përfundoi puna, jo nuk përfundoi puna kush do që ka interes publik, juridik mundet me sfiduar vendimin dhe kandidat të ndryshëm më i larguar nga lista, në qoftë që ka interes nëse dikush synon që ta përdor administratën për arritje të qëllimeve të veta, jo nuk mundet. Gjithë përfshirja është gjithmonë kurdo që frikësohemi të gabojmë është mirë te shkojmë gjithë përfshirje, unë nuk mundem më punua ashtu me marr rolin e prokurorit po ashtu dhe të gjyqtarit. Dikush nga ju po e din qysh kom menduar unë dje, qysh ka menduar zyra.

Eshtref Vishaj: Nuk është mire të flasim për subjekte të tjera politike, personalizimi nuk është i mirë për arsye askund neve nuk na qon, NISMA e përkushtuar për zbatimet dhe sundimin e ligjit, për kundër asaj që i ka vërejtjet e veta në këtë proces dhe sa i përket aktgjyqimit e Gjykatës Kushtetuese administrata ka përfillur një procedurë e cila është e rregulluar më ligj, ne tani jemi ne stadin që duhet ti votojmë rekomandimet mbi bazën e procedurave të rregulluara edhe me rregullore të punës Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, mos ta teprojmë dhe të vazhdojmë më punën.

Sami Kurteshi: Qysh në fillim, po pajtohem me Z. Vishaj që secila parti ka përfaqësuesit e vet, çështja e dytë është që.... Presionin që ka bërë Z. Elshani, nuk është presion është kërcënime që ka bërë ndaj zyrës dhe ndaj Z. Buleshaj. Unë, po ju propozojë juve edhe mediave te ja jepni këtë letër që e lexuat mediave le ta shohin, nëse nuk qenka kërcënime dhe presion. Unë jam i vetmi anëtar i KQZ-ës që nuk e kam e kam vlerësuar Z.Buleshaj për vitin e kaluar për një arsye se kam pasur bindje që nuk e kam njoftuar mjaftë dhe nuk ja kam dhanë vlerësimin tim, e di që të gjitha vlerësimet e tjera kanë qenë të shkëlqyeshme, as nuk kam pasur për ose kundër, vetëm e kam pasur përshtypjen që nuk e njoh mirë. Presioni që e keni ndryshuar mendimin, ne presion të dikujt kjo dëshmon që ju duhet të keni informata sepse dikush po i bejka presion, nëse dikush qenka ai presion duhet të ketë emër. Unë mendoj se secili nga ne edhe Z. Buleshaj e ka një përgjithësi ligjore edhe unë mendoj së ata që mendojnë që këtu ka gjera të tilla dhe unë bej përsëri ftes prokurorisë edhe gjykatës që të i përfundoj këto punë ashtu siç i ka hije, por jo me akuza, të pavërteta.

Arianit Elshani: Z. Kurteshi i keni procesverbalet për zgjedhjet e Podujevës po ashtu dhe të Mitrovicës se Veriut, dhe ato të 2019, edhe të 2017, 2014 i keni secilën listë veç e veç , unë nuk po them që nuk do ti votojmë, nuk do ti hedhim në votim, i hedhim kështu siç i keni sjellë listat të plota, kështu siç i keni sjellë ju edhe me zëvendësime edhe pa zëvendësime secilën do ta votojmë.

Sami Kurteshi: çështja është që mundësin dhe potencialin për të ushtruar presion politik qoftë dhe ekonomik apo shtetëror nuk e kemi ne disa parti këtu dihet cilat parti e kanë nuk po dua që ti përmendi. Por dihet cilat parti e kanë potencialin politik, policor, ekonomik në këtë vend më ushtruar presion mbi persona të caktuar, grupe të caktuara për ti ndryshuar mendimet. Unë po mendojë që kjo është një akuzë dhe kërcenim aq i rend për Z. Buleshkaj dhe zyrën, ndoshta edhe duke e përdorur potencialin që e posedoni edhe ju si parti edhe ti si person. Mirëpo është një rekomandim i bazuar ne ligjin, rekomandimi i zyrës të votohet kështu siç është dhe të hapet rrugë për ndjekjen e hapeve ligjor që na i garanton edhe ligji po ashtu edhe rregullorja, dhe kushtetuta. Selektimi diskriminues, negativ përpjekja për të copëtuar dhe për të luajtur, dhe për tu futur mandej në pazare politike, votoma ti mu këtë sepse unë ty këtë, ne si përfaques të Lëvizjes Vetëvendosje nuk hymë në këto pazare politike, prandaj jemi për votimin dhe nxjerrjen në votim të rekomandimit të zyrës për regjistrimin e partive politike, ne nuk jemi të interesuar që ri bëjmë këto pazare. Ne nganjëherë votojmë edhe kundër sepse ne kemi lirin për të vendosur vet, por nuk pranoj asnjë lloj selektimi negativ...

Sami Hamiti: Z. Kurteshi, u mundova të tregojë që e kemi zbatuar ligjin dhe i kemi votuar një nga një, pyetni anëtarët e juaj paraprak, besoj që do ju tregojnë që a është bërë ndonjëherë pazare me ta për votim të listës së Vetëvendosjes, kurrë nuk ka ndodhur. Asnjë nga subjektet politike ne certifikim nuk kemi pasur problem, nuk ka lypur askush pazare as atëherë dhe as tash.

Alim Rama: Doja vetëm më konfirmuar ligjin, sipas ligjit zyra i paraqet rekomandim më shkrim KQZ-ës për ose kundër certifikimit të listës brenda 10 ditëve të punës, ligji po thotë për ose kundër dhe ajo është mundësia. Në bazë të rregullore së KQZ-ës, ne gjithmonë i votojmë njëherë rekomandimet e zyrës. Kështu që unë mendojë që të votohet rekomandimi e zyrës siç është, në qoftë që ky rekomandim nuk kalon dhe të dalin prej kësaj shtate, njëherë të votohet rekomandimi e zyrës ashtu siç është dhe ajo është kërkesa dhe rekomandimi, pastaj nëse nuk merr vota të mjaftueshme atëherë kalojmë në pjesët tjera dhe unë mendojë që nuk ka zgjidhje tjetër, ne mundemi me vazhduar 2 ditë apo 3 ditë për ose kundër, por ne kemi një rekomandim dhe ne duhet të e votojmë atë. Unë e përkrahi listën time, subjektin tim qëndroj prapa

qëndrimit që ju kanë dhënë përgjigjes, kështu që unë nuk e votoj listën në plotësi e të gjitha listat të tjera sepse nuk me takon mua me i ndërhy subjekteve tjera që me pa a është lista e pastër apo e papastër ajo i takon qytetareve dhe subjektit të vetë dhe nuk është problemi im, nuk po me intereson cila është listë e pastër ose e papastër, për atë dalim në votim dhe gjyqtari vendos. Kështu që të lutem ta përfundojmë këtë punë të qesim në votim dhe ta votojmë siç është rekomandimi.

Valdete Daka : Kurrë nuk i kemi votuar në pako subjektet politike dhe nuk mundemi më i votuar sepse nuk është e drejt, secili subjekt politikë i ka specifikat e veta. A është në rekomandim secili subjekt veç e veç.

Alim Rama: Votoje rregulloren, votoje rekomandimin KQZ-ës, hedhe në votim le të dëgjohet mendimi i secilit për neve, vazhdon me votimin e dytë, të tret, të katërt në qoftë se nuk kalon i pari. Kalojmë njëherë të votimi i parë, votimi i parë është sipas rregullores rekomandimit që vjen nga zyra, zyra është e qartë, zyra rekomandon certifikimin të gjitha subjekteve të cilat kanë aplikuar për certifikim dhe kandidateve të tyre, ai është rekomandimi.

Valdete Daka: Neni 26, pika N, zyra i bëjnë një rekomandim të shkruar KQZ-ës për ose kundër certifikimit të secilës listë të kandidateve të pranuar jo më vonë se 5 ditë punë pas afatit për dorëzim të listave.

Sami Kurteshi: Kam një pyetje për drejtorin e ZRPP-s, në vitin 2019 si është votuar dhe në vitin 2017, 2014.

Ylli Buleshkaj: Për 2019 sa e kujtoj unë kemi votuar në pako e për zgjedhjet tjera nuk e di që ka pasur një konsensus. Edhe at kohë kemi thënë se i kanë plotësuar kushtet mesa e di unë

Valdete Daka: Në 2017, kur është bërë verifikimi i kemi votuar secilin veç e veç.

Ylli Buleshkaj: Në rekomandim i keni të specifikuar edhe për secilin subjekt politik se si jemi ardhur te përfundimi. Ne nuk kam pengesë, e kemi dhënë një rekomandim edhe pres që të shqyrtohet.

Valdete Daka: Kush është për të votuar në pako? Janë 5 vota. Kush është kundër? Kush abstenon? Kemi 5 vota për pako. Kush është për të votuar një nga një? 6 vota. Kush është kundër? Kush abstenon?

Alim Rama: Unë e thashë rregullorja e KQZ-s është e qartë, votohet njëherë ky rekomandim si është pastaj kthehem tek opsionet e tjera. Për mua rregulloret e punës në çdo rast deri tash ka qenë që rekomandimi i zyrës votohet në pako. Në fillim të lexohet rekomandimi dhe të del në votim siç është, kjo është rregullorja e punës që kërkon KQZ-ja. Nuk u lexua drejt çka është votimi.

Sami Kurteshi: Rekomandimi i zyrës nuk është ky ju e keni nxjerr një të ri. Sot ne e kemi votuar një rend ditë për të cilën kemi votuar gjithë më duket edhe në piken e rendit të ditës i kemi 2 pika të veçanta. Shqyrtim dhe miratim i rekomandimit për akreditim të vëzhguesve, kaloj. Shqyrtim dhe miratim i rekomandimit për certifikim të subjekteve politike dhe kandidateve të tyre.

Alim Rama: Unë, po e shoh që ne kemi filluar mbledhjen në orën 14:00 diku nga ora 15:00 e diçka kemi dalë në pauzë pa mendimin e shumicës por në rregull është. Dhe ju tërë kohës po e zhegitni edhe po e shtyni ajo çka na pret para nesh është votimi i rekomandimit si ka ardhur nga zyra, gjithmonë po tentojmë me i dhen një ngjyrë, një ngjyrë tjetër, një formë tjetër dhe krejt me qëllime të caktuara. Të lutem si e përcakton rregullorja, zbatohet rregulloren qite pakon në votim atëherë le të votojnë kundër, unë askënd nuk e obligoj që të voton. Vendose në votim rekomandimin ashtu siç është.

Valdete Daka: Ne po me duket që votuam diçka, në pako certifikimi i subjekteve në bazë të rekomandimit. Z. Kurteshi në qoftë se votohet në pako qysh paramendoni ju që mundet me u ankuar një subjekt, kur e ka vendimin sepse vendimi i KQZ-ës ka me dal, votohen në pako subjektet politike po certifikohen në pako subjektet politike. A keni pa ndonjë herë vendim të tillë të KQZ-ës? Ma gjeni një vendim kur kemi pasur ne një vendim të KQZ-ës certifikohen ne pako subjektet politike, a po ma e gjeni një venim të tillë.

Sami Kurteshi: Unë kisha lut drejtorin e zyrës politike nëse ka, nëse s'ka. Secili person i prekur ose secili person që ka interes, secili subjekt politik ka të drejtë me ankimuar, me sfidua çdo vendim të KQZ-së. Për secilin person edhe për secilën listë edhe nëse ju nuk e keni të qartë qysh bohet është rregullativ ligjore. Secili person që ka interes juridik, secili subjekt politik ka të drejt me e sfidua, me rrugën ligjore çdo subjekt politik, çdo listë, dhe çdo person në organet gjyqësore që i kemi PZAP-ja dhe Gjykata Supreme.

Valdete Daka: E qysh ka me e apelua ata në PZAP kur e kemi në pako.

Arianit Elshani: Vendimet janë për secilin veç e veç, nuk janë të përfshirë 1000 e sa kandidatë sa jena në total. Andaj meqenëse vendimet janë veç e veç, ligji thotë veç e veç, praktikat janë veç e veç, votoni veç e veç. Ju thashë për numrat i keni mos keni punua natën.

Valdete Daka: Na, i kemi të bashkangjitura vendimet për secilin subjekt veç e veç...

Alim Rama: Më fal kryesuese. Unë e lexova nenin 26.5 i cili thotë: votohen listat e kandidatëve. Praktika e punës edhe rregullorja e KQZ-së thotë se, një herë votohet rekomandimi I zyrës. Pastaj mundemi me votua ndryshe por njëherë votohet rekomandimi I zyrës. Dhe ka qenë praktika gjithmonë kështu. Edhe një herë votohet rekomandimi I zyrës. Të lutem lexoje rekomandimin e zyrës, qite në votim. Kush është pro? Kush është kundër? Kush abstenon. S'kemi asgjë tjetër. Vetëm përmbaju rregullores...

Valdete Daka: Cila është arsyeja, pse ju nuk po doni mi votuar veç e veç?

Sami Kurteshi: Është një rekomandim i ZRPP-s. Votohet rekomandimi, për, kundër ose abstenohet secilit subjekt i shkon veç e veç.

Čemailj Kurtiši: Nuk e kisha ndërmend të diskutoj, por jam i shtyrë! Këtu, po luhet me fjalë, po filozofohet. Unë, do të diskutoj s'i i pavarur, dhe unë kam integritet edhe kur janë në pyetje interesat partiake. Gjykoj, se çka duhet të votoj...! Unë, edhe jam konsultuar...dhe, këtu kemi një vendim se, a do të votojmë në paketë, apo veç e veç...Në rekomandimin e ZRPP-së, nuk na është specifikuar s'i të votohet...U konsultova me anëtarët më të vjetër, dhe tradita është që të votohet veç e veç...! Ne, duhet të vendosim dhe nuk shohë ndonjë problem që të votohet, veç e veç...Dhe, s'kemi pse të frikësohemi...Kush dëshiron, edhe mund të ankohet...

Valdete Daka: Ishte pra kjo arsyeja kryesore se secili subjekt i ka specifikat e veta, secili subjekt ka pas kërkesa jo secili po disa prej tyre dhe disa i kanë zëvendësua kandidatët. Disa subjekte, kanë pasur probleme për arsye se i kanë zëvendësua kandidatët dhe kanë konsideruar se i kanë të mirë. Dhe, nuk mundet në paket të vendoset diçka që nuk është e njëjtë për të gjithë, nuk mundet. Secili subjekt politik i ka specifikat e veta siç thash që nga fillimi. Secili subjekt politikë, votohet veç e veç sepse është i veçantë është në garë ka hy veç, nuk ka hy në paketë me kërkon në garë. Nuk kanë aplikuar në paket. Kanë aplikuar

veç e veç secili dhe do të certifikohen veç e veç sepse ndoshta një subjekt ka një problem, një subjekt s'ka problem ajo është çështje e subjekteve pastaj.

Sami Hamiti: Jemi tu fol për çështje fundamentale që e ka specifiku saktë. Mundesh edhe të thuash praktika, mundesh të thuash edhe rregullore. As rregullorja e as praktika nuk janë.. Ligji është i saktë, shumë saktë bre. Zyra e bënë një rekomandim të shkruar KQZ-së pro ose kundër certifikimit të secilit listë të kandidatëve. Ligji po thotë jo rregulla të kandidatëve të pranuar jo më shumë se 5 dit pune pas pranimi të saj.

Arianit Elshani: Nuk do ti votoj ata të cilët i ka listuar këshilli gjyqësor i Kosovës. Ndërsa dua me votua për secilën listë dhe person i cili nuk është i listuar nga këshilli gjyqësor.

Sami Kurteshi: Znj. Daka ne e kemi për detyrë ta votojmë rekomandimin e ZRPP-s. Këtu u kërcënua në mënyrë të qartë hapur drejtori i ZRPP-s përndjekje, dhe ju bë presion për çka sepse ka marrë një vendim edhe ka bere një rekomandim KQZ-së të mbështetur në ligj dhe tash hapur shihet nga kush edhe pse edhe tash aj dëshiron të hidhet poshtë edhe të luhet me fjalë. Jo kjo, jo veç e veç, jo lista. Ne sigurisht do të dalim në binarët e caktuar. Ende askush s'po guxon me përmend emrin për çka bëhet kjo zhurmë krejt edhe na nuk e kemi ndërmend me përmend, por ne e kemi ndërmend me kërkuar që me u respektuar rekomandimi i ZRPP-s. Nga kjo, pa dalë ky rekomandim në votim ne nuk dalim nga këtu.

Alim Rama: Ju nuk e përfilleni rregulloren, rregullat që disa herë na keni kthyer së fundmi në udhëzimin administrative. Gjithmonë e merrni parasysh mendimin dhe rekomandimin e zyrës ose këshillit përgjegjës cili do që të jetë. Vetëm kësaj here nuk e qiteni në votim, një rekomandim të qartë. Rekomandimi është shumë i qartë s'ka nevojë të bëhet seleksionimi i subjekteve, te votohet. Secili janë kushtet e njëjta.

Valdete Daka: Secili subjekt është në kusht të njëjtë por nuk i ka plotësuar kushtet e njëjta.

Alim Rama: Në vend se të jemi referuar i padukshëm, na po bohemi lojtarë kryesor. Lëreni qytetarët të vendosin, po doni me vendos në emër të qytetarëve. Ky bon ky s'bon, jo kjo lista nuk banë jo kjo bon. Është një rekomandim i kanë plotësua kushtet secilit në bazë të rekomandimit të zyrës, lëreni qytetarët të vazhdojmë më tutje. Unë e përmenda edhe paradite. Na duhet me u be procesi i anketimit vazhdon i ka afatet ligjore ato nuk janë zvogëluar asnjë. Kemi shortin dhe kemi me filluar me votim jashtë Kosovës.

Arianit Elshani: Mbledhja përveç që buron nga ligji, buron edhe nga rregullorja. Ashtu siç mund të vendosim për votim të fshehur mund të vendosim edhe për mënyrën e votimit. Këtë rast kemi vendosur mënyrën e votimit, kemi vendos që secila të jetë veç e veç.

Sami Kurteshi: Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për certifikim të subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre. E kemi një rekomandim... Ky është një selektimi negativ, diskriminimi, përpjekja për të ndaluar parti dhe kandidat të caktuar të dalin në votim në garën e 14 shkurtit, po duket qartë. Kjo ka të bëjë me emrin e "Albin Kurtit" dhe kjo po duket qartë, dhe po duket presioni që u bë dhe si, dhe pastaj janë futur edhe lista të tjera aty...

Sami Hamiti: Po e citoj kërkesën e Vetëvendosjes në Gjykatën Kushtetuese, pika 93: "Etem Arifi nuk është dashur të certifikohet si kandidat për deputet në nenin 29 të ligjit i cili parasheh që një person është i aftë të kandidojë si kandidat për deputet, përveç nëse pajtohet për vepër penale në një vendim përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese në 3 vitet e fundit". Kjo është kërkesa e Vetëvendosjes në Gjykatë Kushtetuese...

Sami Kurteshi: LVV-ja ka bërë një kërkesë, por kërkesa nuk i ka 93 pika...

Sami Hamiti: Me rëndësi është kërkesa. A mund ta mohoni...?

Arianit Elshani: Kemi vendos për ndryshimin... ! E kemi një rekomandim para vetes, të cilin e votuam për procedurën, mënyrën e votimit. Dhe u aprovua mënyra e votimit secili veç e veç, ashtu siç e thotë ligji. Ligji, është më i madh se një rend dite që e kemi para vetës. Ligji, është mbi rregulloret dhe mbi rekomandimet, andaj ju lutem procedojeni. Vazhdoni veç e veç secilën, votat edhe ndoshta i keni por unë nuk dua të votoj si përfaqësues i PDK-s. Nuk dua të votoj për listat të cilat i ka listuar këshilli. Nuk dua të kem mundësin t'i votoj të gjithë bashkë edhe ata që nuk janë të listuar pre KGJK-s, edhe këta të tjerët që janë të listuar pre KGJK-s. Ky është dallimi. Votën dua ta jap për secilin subjekt, për secilin kandidat i cili është i pastër, për secilin që evidentohet që është si i pa pastër nuk dua ta jap votën. A kam të drejt ta kam këtë qëndrim? Jepmani këtë mundësi, vazhdojmë...

Valdete Daka: Ka subjekte që po më lajmërohen, ata i kanë zëvendësuar kandidatët e tyre. Na e votuam një here, kemi votuar që secili subjekt të votohet veç e veç. Nëse doni me votuar, mirë nëse s'doni me votuar...? Ne e kemi një rekomandim, a po doni me e votue rekomandimin...? Ne, e votuam njëherë që

secili subjekt të votohet veç e veç...! A po doni me votue rekomandimin apo, jo...? Kush është për që të votohen në pako subjektet politike në bazë të rekomandimit të ZRPP ?

Nuk kalon ! 5 vota janë....Nuk kalon... Nuk u apovua rekomandimi i ZRPP-së ?

Valdete Daka: Ka subjekte që po më lajmërohen se i kanë zëvendësuar kandidatët e vet. Ata i kanë zëvendësuar kandidatët e tyre dhe ne tash e votojmë secilin subjekt veç e veç. Ata që i kanë zëvendësuar dhe ata që nuk i kanë zëvendësuar, dhe nuk pajtohen përfaqësuesit këtu që janë. Rrjedhimisht, zyra ka rekomandua që të certifikohen 28 subjekte politike që kanë aplikuar për kandidatëve të tyre në pako. Zyra rekomandon certifikimit e 28 subjekteve politike që kanë aplikuar për certifikim dhe kandidatëve të tyre, pra në pako. Dhe ne thanë që nuk u aprovuar rekomandimi që të aprovohen në pako, jo mu certifikuar 28 subjekte. Tash rekomandojmë secilin veç e veç sepse ka thanë jo 28 përnjëherë. Tash, na shkojmë secilin veç e veç. Zyra ka rekomanduar me u certifikuar 28 e na po themi jo nuk po certifikohen 28 tash shkojmë një nga një, i shohim cilat...? Në i kemi këtu subjektet që kanë aplikuar për certifikim të gjitha veç e veç

Sami Kurteshi: Rekomandimi i zyrës nuk u pranua ?

Valdete Daka: Jo, nuk u pranua...!

Ylli Buleshkej: Ajo të cilën unë e kërkoj si zyrë pa marr parasysh çfarë vendimi, është nëse doni ta merrni sado pak parasysh mendimin e zyrës. I keni të shkruamë ne shkresë. Jo tabelë informuese sepse ka ma pakë kandidatë aty. Shkresa e zyrës e keni një nga një, secilin subjekt ashtu siç kemi arrit ti verifikojnë me radhë. I keni prej 1 deri në 28. Edhe ceket kur kanë aplikuar, sa kanë kandidatë. Edhe shtojcën e kandidatëve e keni edhe shtojcën mbrapa për me ditë kon pe votoni.

Arianit Elshani: Është mirë të sqaroni ju thashë listën se sa persona i kanë të listuar nga KGJK-ja sepse kështu siç e keni sjellë nuk shoh informatë se sa persona i kanë të listuar nga KGJK-ja. Si informatë e kemi këtu jo në vendim se si ta votojmë ose na sqaron ti...

Valdete Daka: I kemi të listuar subjektet politike edhe këtu i kemi një shënim për secilin subjekt. Numër një është partia politike "Nisma Social Demokrate", e cila e ka dorëzuar dokumentacionin për certifikim të subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre. Pas kontrollit të dokumentacionit zyra ka dërgua shkresë për përmirësim të dokumentacionit me 17 janar te subjektit politikë të cilat kanë dorëzua përmirësimet e

nevojshme brenda afatit. Në kuadër të obligimeve zyra ka dërgua emrat e kandidatëve të këtij subjekti politikë për verifikim. Të nevojshëm, të theksuar me nenin 29 të ligjit 29 për zgjedhjet e përgjithshme dhe pas verifikimit të nevojshëm. Zyra rekomandon certifikimin e subjektit politik dhe 110 kandidatë të këtij subjekti. Nëse mundet drejtori të na tregoj a janë zëvendësuar kandidatët te Nisma. Propozimi i parë është deri me ditën e certifikimit. Kush është për? Kush është kundër? Kush abstenon? Me 9 vota për është aprovuar që verifikimi dhe certifikimi i kandidatëve të jetë deri në ditën e fundit me datën 22, ditën e sotme. Ne i kemi këtu subjektet politike që nuk i kanë larguar kandidatët dhe ne votojmë për subjektet dhe kandidatët tash a do ta votojmë subjektin me apo pa këta kandidat që janë me pengesa.

Sami Hamiti: Nuk kam problem, ato subjekte që janë parlamentare të certifikuara asnjë listë të subjekteve politike kanë një kandidat që është ndesh me nenin 29 pika Ç, nuk e votoj. Prandaj kërkoj nga zyra që të mi specifikoj unë nuk e kam problem. Nuk e kam problem me listat që nuk e kanë ndonjë kandidat me ligjin dhe aktgjykimin edhe të Gjykatës Kushtetuese.

Alim Rama: Ne sot nuk i certifikuam listat, kështu që i votojmë s'i është lista e bashkangjitur. Votoni një nga një...

Eshref Vishi: Z. Sami, nëse keni ndonjë problem me ndonjë kandidat në listë mund të apelojsh në PZAP dhe gjykatë. Nuk është telashe !

Valdete Daka: Nëse një listë nuk ka kandidat me probleme nuk është faji i tyre që mos të certifikohen ata. Sepse ne po i certifikojmë kandidat të cilët kanë të drejt edhe të cilët nuk kanë faj që dikush që është në listë me ta dhe ka një problem. Ne, e kemi këtu Nismën Social Demokrate e cila i ka 12 emra që kanë probleme. Qitet në votim kandidatët e "Nismës Social Demokrate", e cila nuk i ka zëvendësuar kandidatët siç është kërkuar nga zyra, janë 12 kandidat që nuk janë zëvendësuar dhe nuk i plotësojnë nenin 29 të ligjit për zgjedhje e përgjithshme edhe pse unë e konsideroj që duhet të votohet për kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet ligjore dhe jo e gjithë lista ta bart fatin e atyre që nuk i plotësojnë kushtet, sepse nuk është faji i atyre 98 kandidatëve që i plotësojnë kushtet dhe që i kanë kaluar. Sepse ne i votojmë secilin kandidat veç e veç.

Eshref Vishi: Unë, nuk pajtohem me konstatimin e juaj dhe jam pran rekomandimit të zyrës që e lexova më herët, por po e lexoj dhe njëherë. Zyra rekomandon certifikimin e subjektit politik me 110 kandidat të

Nismës Social Demokrate sipas listës së bashkangjitur dhe shtojcës 1 të këtij rekomandimi. Unë dua kështu të votohet.

Ibrahim Selmanaj: Në rastin konkret këtu është e specifikuar mirë, me qenë se Nisma ka qenë në koalicion a kërkon të certifikohet si subjekt politik njëherë a është gabim njëherë të certifikohet subjekti politik po në të njëjtën kohë edhe lista prej 110 kandidatëve. A mos e kam gabim pyetjen?

Eshref Vishi: Gabim e ke. Rekomandimi i zyrës është, “zyra rekomandon certifikimin e subjektit politik me 110 kandidat nuk e ndan subjekti politik nga kandidatët..!”

Sami Hamiti: Unë, nuk kam asgjë kundër Nismës si subjekt politik të certifikohet. Kam kundër atyre 12 deputetëve që ndodhen në listën dhe janë ndesh me neni 29 prandaj, po ma pamundësoni votimin, sepse nuk do të votoj për kandidatët..

Eshref Vishi: Nuk dua ta determinoj votën tënde se a voton pro, apo kundër! Problemet e Nismës, Nisma i bart vet...

Valdete Daka: Neni 26 përcakton që lista e kandidatëve votohet veç. Zyra i bënë një rekomandim KKZ-s për ose kundër certifikimit të secilës listë të kandidatëve, nuk thotë të subjektit dhe listës.

Arianit Elshani: Keni parasysh që kemi instucione të tjera kemi PZAP-in, kemi Gjykatën Supreme. Propozoj që të ndahen veç e veç, i kemi edhe partitë e komuniteteve që nuk kanë qenë pjesë e kuvendit. Në anën tjetër kemi edhe subjekte si Nisma që në këtë rast disa anëtar duke përfshirë edhe unë dëshirojmë që ta certifikojmë si subjekt, si listë e bëjmë ndaras.

Valdete Daka: Kush është që të certifikohet Nisma si subjekt politik dhe lista me kandidat. Kush është kundër? Kush abstenon? Me 6 vota nuk certifikohet as Nisma as kandidatët. Vazhdojmë me LVV-n. Edhe lista e Vetëvendosjes nuk ka zëvendësuar kandidatët e të cilët është kërkuar sipas ZRPP-s:

“Partia politike VV-s ka dorëzuar listën për certifikim të kandidatëve të tyre me datën 16 janar 2021. Pas kontrollimit të dokumentacionit zyra ka dërguar shkresë për përmirësim të dokumentacionit me 17 janar te subjekti politik të cilët kanë dorëzuar përmirësimin e nevojshëm brenda afatit, në kuadër të obligimeve ligjore zyra ka dorëzuar emrat e kandidatëve të këtij subjekti politik për verifikim. E nevojshme të theksuara

në nenin 29 të ligjit për zgjedhje të përgjithshme. Dhe pas verifikimeve të nevojshme zyra rekomandon certifikimin e 110 kandidatëve të LVV-s sipas listës së bashkangjitur është shtojca dy. “

Kjo, nuk qëndron për asnjërin subjekt është ajo që janë dërguar shkresat për tu zëvendësuar kandidatët të cilët kanë pas probleme me nenin 29 dhe të njëjtit nuk e kanë zëvendësuar. Janë 5 kandidat për deputet që nuk janë zëvendësuar. Atëherë kush është për që LVV-ja nuk duhet të certifikohet si subjekt sepse, ka qenë si subjekt në zgjedhjet e fundit parlamentare e certifikuar dhe është parti parlamentare dhe nuk ka nevojë të certifikohet si subjekt. Por, ka nevojë të certifikohet lista e deputetëve. Unë përsëri e them që nuk është e drejt që kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet dhe të cilët nuk kanë probleme për mos certifikim, por të hidhet në votim lista ashtu sic është pa ata 5 kandidat. Kush është që të certifikohet lista e LVV-s? Kush është kundër? 1 kundër. Kush abstenon ? Me 5 vota për, nuk certifikohet lista e kandidatëve të LVV-s.

Vazhdojmë me AAK-n. Nuk po e lexoj tekstin se, është i njëjtë...!

Ibrahim Selmanaj: Unë përfaqësoj AAK-n dhe propozoj që paraprakisht të certifikohet subjekti im politik, kërkoj miratimin e anëtarëve të KQZ-s. Ndërsa vendimi tjetër rreth listës të jetë një vendim tjetër, sepse është interesi i partisë sime. Besoj se duhet të merret parasysh propozimi im.

Valdete Daka: Subjekti politik AAK nuk është i certifikuar sepse në zgjedhjet e kaluara ka qenë në koalicion prandaj, kërkohej që të certifikohet si subjekt. Pra kush është për që të certifikohet si subjekt AAK? Ndërsa anëtari kërkon që lista e subjektit të tij të certifikohet jo si u propozua nga të tjerët, po të certifikohen kandidatët që nuk kanë probleme. Kush është për certifikimin e listës së AAK-s, me defekte? Kush është kundër? Kush abstenon? Me 6 vota kundër, nuk kalon as lista e AAK-s.

Partia politike LDK. Kush është për certifikimin e listës së LDK-s? Kush është kundër? Kush abstenon? Certifikohet lista e LDK-s. PDK, edhe kjo parti nuk ka nevojë të certifikohet si subjekt por vetëm lista. Sa kandidat ka pasur nevojë të ndërrohet, është ndërruar? Kush është për certifikimin e listës së PDK-s. Faleminderit, me 10 vota për. Kush është kundër? Një abstenim? Partia Lista Srbska, edhe kjo parti nuk ka nevojë për certifikim sepse është parti parlamentare, ndërkaq zyra na ka njoftuar se edhe kjo listë ka pasur kandidat që nuk është dashur të zëvendësohen. Një kandidat, a është zëvendësuar. Kush është për certifikimin e kësaj liste? Me 10 vota për, certifikohet. Lista Romani Iniciativa, kjo duhet të certifikohet edhe si subjekt edhe me kandidat. Kush është për që të certifikohet edhe subjekti edhe lista Romani Iniciativa. 10 vota për, faleminderit. Vazhdojmë me Partia Rome e Bashkuar e Kosovës, PREB. Ka pasur kandidat që është dashur të zëvendësohet, janë zëvendësuar. Kush është për certifikimin e kësaj liste?

Faleminderit. Partia JGP, nuk ka nevojë për certifikim. Kush është për certifikimin e Jedinska Goranska Partia? Kundër? Kush abstenon? Iniciativa Qytetare Jedinja Zajendnica Adriana Hoxhiq, duhet të certifikohet si subjekt. A ka pasur nevojë për ndryshime, është zëvendësuar. Kush është për? Kush është kundër? Vazhdojmë me iniciativa qytetare Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës, LPRK, kjo duhet të certifikohet. A ka pasur kandidat të cilët është dashur të zëvendësohet? Jo, kush është për certifikim? Partia Balliste. Kush është për certifikimin e partisë dhe listës? 11 vota për. Partia SDU. Kush është për certifikimin e SDU së bashku me kandidat? PDAK, a ka nevojë që të certifikohet, kandidatët a janë zëvendësuar...

Artan Asllani: Kisha dashur të shtoj me shqetësimin që e kemi ngritur disa herë. Në lidhje me PDAK dhe Lëvizjen për Bashkëveprim, kanë pasur ti mbledhin edhe 1.000 nënshkrime nuk e di ZRPP-ja a i kanë kaluar të gjitha filtrat edhe gjitha kërkesat a i kanë përmbushur.

Ylli Buleshkaj: Po për herë të parë të zyrës i kemi verifikuar strikt çdo nënshkrim. Përveç verifikimit të nënshkrimit i kemi thirrur edhe në telefon sepse kemi pasur informata jo zyrtare se informatat janë keqpërdorur dhe një pjesë e tyre që kanë pasur numër janë thirr dhe janë pyetur. Dhe nuk ka pasur keqpërdorime.

Valdete Daka: Po e votojmë në fillim certifikimin e partisë. Kush është për votimin e listës së kandidatëve? Kush është kundër? Kush abstenon? Nuk kalon. Lëvizja për Bashkëveprim, a ka duhet të certifikohet. Kush është për certifikimin e subjektit dhe kandidatëve? Partia YTPP duhet të certifikohet edhe si subjekt, edhe kandidatët a kanë ndonjë problem, jo. Kush është për? Kush është kundër? Kush abstenon? Me një abstenim aprovohet. IRDK a duhet të certifikohet si parti, jo. Lista a ka pasur probleme. Kush është për? Vazhdojmë me Nasha Iniciativa. Kush është për certifikim? Kush është kundër? Kush abstenon? KDTP, nuk ka nevojë të certifikohet sepse është parti parlamentare, a ka ndonjë emër me problem. Kush është për? Partia KNRP. A ka nevojë për certifikim? Kandidatët a kanë ndonjë problem? Kush është për? Partia LPE, nuk duhet të certifikohet sepse është parti parlamentare, a ka ndonjë kandidat për tu zëvendësuar. Kush është për? Partia PAJ, nuk duhet të certifikohet vetëm lista e kandidatëve duhet të certifikohet. Kandidatët a kanë problem, janë zëvendësuar? Jo. Kush është për certifikimin e partisë PAJ? Kush është kundër? Kush abstenon? Nuk kalon kjo listë.

Partia Fjala duhet të certifikohet si subjekt dhe kandidatët a duhet ti zëvendësohen. Kush është për? Partia NDS, nuk ka nevojë të certifikohet si parti politike, a ka ndonjë problem me kandidat, i kanë larguar. Kush është për? Koalicioni VAKAT, a duhet të certifikohet, vetëm lista? Kush është për? Faleminderit. Partia

ZAJEDNO. Kush është për? Kush është kundër? Kush abstemon? Iniciativa qytetare GISP-o, kjo duhet të certifikohet a ka nevojë për listë. Kush është për? Iniciativa SDS a ka probleme me listë. Kush është për? Kush është kundër? Kush abstemon? Këto janë pra 28 subjektet politike. Nga momenti i pranimit të KQZ-s të gjithë ata që konsiderojnë se pa të drejt nuk janë certifikuar kanë të drejt ankese prej 24 orëve në PZAP.

Eshref Vishi: Unë konsideroj që votimi për certifikim të subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre sonte ishte politik, tendencioz ndaj subjektit Nisma. Nuk është përgjegjësi e anëtarëve të KQZ-s të shqetësohen për përmbajtjen e listës së subjektit politik Nisma dhe asnjë subjekti politik. Është e drejt e tyre të votojnë në bazë të rekomandimeve të ZRPP-s, por u pa që as rekomandimet e zyrës nuk u përfillën por as rekomandimet as gabimet tona si anëtar të KQZ-s në lidhje me respektimin e procedurave zgjedhore për certifikimin e subjektit dhe listës. Nuk ka problem, ne do të ankohe mi do ti përfillim ankimore ligjore...

Sami Kurteshi: Lista e LVV-s nuk u certifikua, kjo ka qenë prapavijë e gjithë kësaj. Vetëm po ju tregoj një rast çka nuk u certifikua. Kemi një vendim ligjor për njërin nga kandidatët sepse ka kryer vepër penale për rrezikim të trafikut nga neni 131 dhe ky është dënimi që dikush dëshiron ta largoj nga lista. E pa ndehura obligohet ti paguaj shpenzimet e procedurës penale aq sa të bëhet, 40,88 cent, si dhe shumë prej 20 euro për ekspertizë ligjore si dhe paushallin ligjor në shumë prej 30 euro. Për këtë nuk certifikohet lista e LVV-s, kemi edhe raste të tjera por kjo është absurdi me të cilën ka filluar fushata politike ndaj LVV-s, ndaj kandidatëve. Kjo është përgjigjja e KGJK-s dhe për këtë e kanë ngritur dorën pro ose kundër anëtarët këtu. Merreni me mend për 60 euro dënim në komunikacion.

Eshref Vishi: Nuk e di me kë do të garojnë subjektet politike me 14 shkurt, përjashtohen subjektet parlamentare dhe nuk certifikohen. Nuk e di se si do të zhvillohet gara politike...

Ibrahim Selmanaj: Edhe lista e AAK-s nuk është votuar nga anëtarët e KQZ-s. Aleanca nuk ka votë për kandidatët që do të votohen, edhe procesi duhet të vazhdoj në atë që kemi ndërruar dhe i kemi ligjet e aplikuar në Kosovë. Unë uroj që secili subjekt politik të jetë i suksesshëm në garë dhe i uroj edhe atyre që nuk janë përfshirë sot që nuk i patën votat besoj që kanë për ti kaluar filtrat dhe do të jenë në garë. Urime të gjithëve.

Alim Rama: Në emër të listës së LVV-s, po kanë frik në vendvotime po e anulojnë listën në KQZ por bashkërisht edhe disa lista të tjera të kolegëve këtu. Kështu që besojmë që ky vendim absurd i KQZ-s të

korrigjohet së shpejti dhe secili anëtar të mbaj përgjegjësi. Ka ndodhur edhe një rast ne kemi mohuar certifikimin e një subjekti PZAP-i na ka kthyer në zgjedhjet e nëntorit, ky absurdi nuk ka nevojë të përsëritet dhe secili subjekt është për garë te zgjedhësit jo në tavolinë. Secili subjekt ka të drejt për listën e vet, i kanë plotësuar të gjitha kriteret në bazë të ligjit kështu që absurdi i votimit të anëtarëve të KQZ-s për mua është i pakapshëm...